



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIA PROTIV KORRUPCIE
ANTI-CORRUPTION AGENCY



RAPORTI VJETOR 2009

1 janar – 31 dhjetor

TABELA E PERMBAJTJES

I.	HYRJE	3
II.	PJESA E PËRGJITHSHME.....	4
III.	KËSHILLI I AKK-SË.....	4
IV.	ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AKK-SË	5
V.	LUFTIMI I KORRUPSIONIT	5
1.	ZBATIMI I LIGJIT	6
a.	<i>Zhvillimi i hetimeve.....</i>	6
b.	<i>Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë mision luftën kundër korrupsionit</i>	17
2.	STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT	18
a.	<i>Përgatitja dhe aprovimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit.....</i>	18
b.	<i>Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit.....</i>	19
3.	KOMPLETIMI I LEGJSLACIONIT DHE EDUKIMI.....	22
a.	<i>Përgatitja e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit</i>	22
b.	<i>Edukimi – ngritja e vetëdijes së publikut për fenomenin e korrupsionit dhe pasojat negative të tij</i>	23
VI.	PARANDALIMI I KORRUPSIONIT	23
1.	MBIKËQYRJA E PASURISË DHE KONTROLLI	24
a.	<i>Mbikëqyrja e pasurisë.....</i>	24
b.	<i>Kontrollimi i Formularëve për Deklarim të Pasurisë.....</i>	27
2.	MBIKËQYRJA E DHURATAVE	29
a.	<i>Katalogu i Dhuratave.....</i>	29
3.	PARANDALIMI I KONFLIKTIT TE INTERESIT.....	30
a.	<i>Baza ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit</i>	31
VII.	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	33
I.	TAKIMET ME GAZETARË DHE QYTETARË.....	33
II.	KONFERENCAT DHE KOMUNIKATAT PËR SHTYP.....	34
III.	MONITORIMI I MEDIAVE.....	34
IV.	FAQJA ZYRTARE E INTERNETIT	38
V.	BASHKËPUNIMI DHE AKTIVITETET TJERA	38
VI.	ORGANIZIMI I KONFERENCËS RAJONALE NË PRISHTINË	38
VII.	NDARJA E ÇMIMIT PËR GAZETARI.....	38
VIII.	ADMINISTRATA / BUXHETI.....	39
1.	HARTIMI I BUXHETIT VJETOR	39
2.	MBIKËQYRJA E REALIZIMIT TË SHPENZIMEVE	39
3.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	40
4.	AKTIVITETET TJERA.....	42
IX.	PROKURIMI	42
X.	SFIDAT DHE VËSHTIRËSITË.....	44
XI.	PËRFUNDIM	44
XII.	SHTOJCA I: ORGANOGRAMI.....	46

I. HYRJE

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të vitit 2007. Baza ligjore për themelimin e Agjencisë është Ligji kundër Korrupsionit (2004/34) i cili i ka përcaktuar përgjegjësitë dhe fushë veprimtarinë e tij.

Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Ligji aktual kundër korrupsionit, parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Gjatë vitit 2009, Agjencisë i janë shtuar edhe disa aktivitete shtesë duke pasur parasysh se gjatë këtij viti janë miratuar ligjet e reja si: Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligji për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik si dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit. Si aktivitete shtesë mund të përmenden: monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit si dhe rritja numrit të zyrtareve të cilët i nënshtrohen dispozitave të Ligjit për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Gjithashtu është aprovuar edhe Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik me të cilin parashihet rritja e numrit të zyrtarëve të lartë publik të cilët kanë obligim për deklarimin e pasurisë.

Fondet për funksionimin e AKK-së sigurohen nga Buxheti i Kosovës.

II. PJESA E PËRGJITHSHME

Korrupsioni në Kosovë vazhdon të jetë një fenomen i cili po ndikon në ngadalësimin e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Megjithatë kuadri ligjor dhe institucional për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit është përmirësuar dhe po shkon drejt fuqizimit. AKK si institucion i specializuar për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit edhe gjatë vitit 2009 ka intensifikuar përpjekjet me qëllim të ballafaqimit me këtë dukuri negative duke iu bërë pengesë e madhe rritjes së tij përmes shumë aktiviteteve. Kjo ka ndikuar në nxitjen e bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe AKK-së, rritjen e besimit të qytetarëve në punën e AKK-së si dhe përmirësimin e përgjithshëm të imazhit të institucioneve të vendit.

AKK-ja ka krijuar një përvojë të mirë në ndërmarrjen e hapave konkrete kundër veprimeve të dyshuara korruptive, ndërgjegjësimin e opinionit publik për një shoqëri të pa korruptuar si te zyrtarët institucional ashtu edhe tek mediat dhe shoqëria civile.

Pas përgatitjes dhe aprovimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit, AKK ka vendosur një bazë të shëndoshë të bashkëpunimit me të gjitha mekanizmat përgjegjës sa i përket zbatimit të këtyre dokumenteve.

Ky është raporti i tretë vjetor që Agjencia i paraqet Kuvendit të Kosovës, i cili në mënyrë të detajuar i pasqyron aktivitetet dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit 2009. Këto aktivitete kanë qenë të përqendruara në tri shtylla kryesore:

- Zbatimin e ligjit, ku përfshihen përcjellja e informatave për korrupsion në prokuroritë publike kompetente, hartimi i ligjeve të reja për plotësimin e kornizës ligjore në këtë fushë si dhe përgatitja dhe zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit;
- Parandalimin ose eliminimin e shkaqeve të korrupsionit përmes kryerjes së deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë, parandalimit të konfliktit të interesit dhe regjistrimit të dhuratave të pranuar nga personat zyrtar;
- Edukimit të zyrtarëve publikë dhe qytetarëve mbi kornizën ligjore dhe mekanizmat aktual të cilët merren me luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut.

Raporti është një përmbledhje e aktiviteteve vjetore të Agjencisë përmes së cilit publiku mund të shoh progresin e bërë gjatë periudhës së raportimit si dhe të njohë problemet e hasura gjatë zbatimit të detyrave dhe aktiviteteve të kryera nga Agjencia.

III. KËSHILLI I AKK-së

Puna e AKK-së është mbikëqyrur nga Këshilli i AKK-së i cili është organ kolegjal në përbërjen e të cilit janë nëntë përfaqësues që vijnë nga: 3 nga Kuvendi i Kosovës dhe me nga

një përfaqësues nga Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Gjykata Supreme, Prokuroria Publike e Kosovës, Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe shoqëria civile. Anëtarët e Këshillit kanë një mandat prej dy vitesh.

Gjatë periudhës së raportimit Këshilli ka realizuar 7 takime në të cilat janë diskutuar tema që kanë të bëjnë me punën e AKK-së.

Duke u bazuar në Ligjin kundër Korrupsionit, AKK-së çdo gjashtë muaj raporton tek Këshilli në lidhje me përmbajtjen dhe shtrirjen e mbikëqyrjes së pasurive, konfliktin e interesave, dhuratat dhe hetimet e përfunduara si dhe punën dhe aktivitetet e detajuara të kryera nga AKK gjatë periudhës raportuese.

Duhet veçuar se Ligji i ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit nuk e parasheh ekzistimin e Këshillit të Agjencisë dhe i njëjti përcakton se AKK për punën e tij duhet ti raportojë Komisionit Parlamentar kompetent.

IV. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I AKK-së

Organizimi i brendshëm i AKK-së është i rregulluar me anë të Rregullave Procedurale si dhe Vendimit për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Agjencisë, të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar përgjegjësitë e çdo zyrtari në secilin divizion dhe departament si dhe procedurat në lidhje me kryerjen e punëve.

AKK është i përbërë nga Zyra e Drejtorit, tre departamente ku secili departament përbehet nga dy divizione. (shiko shtojcën 1). Aktualisht në Agjenci punojnë 35 zyrtar dhe atë:

- Zyra e Drejtorit të AKK-së, 5 zyrtar;
- Departamenti i Hetimeve, 12 zyrtar;
- Departamenti i Parandalimit, 10 zyrtar, si dhe
- Departamenti i Administratës, 8 zyrtar.

Kapitujt në vijim paraqesin një tablo të plotë të aktiviteteve të kryera nga AKK gjatë periudhës një vjeçare të raportimit, 1 Janar - 31 Dhjetor 2009.

V. LUFTIMI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet e luftimit të korrupsionit në AKK zhvillohen nga Departamenti i Hetimeve.

Mandati ligjor i Departamentit të Hetimeve konsiston në:

- zhvillimin e hetimeve lidhur me akuzat e supozuara për korrupsion në ato raste kur nuk inicohet procedurë penale,

- përcjelljen e rasteve të hetuara tek prokuroria publike kompetente për procedim penal të mëtejshëm,
- bashkëpunimin me të gjitha autoritet vendore dhe ndërkombëtare të ngarkuara për zbatimin e ligjit gjatë procedurave hetimore që kryhen nga këto autoritete,
- përgatitjen e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit,
- përgatitjen e Strategjisë Kundër Korrupsionit për Qeverinë për aprovim nga Kuvendi dhe ka përgjegjësinë për bërjen e amendamenteve dhe implementimin e saj;
- ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimin e opinionit në lidhje me fenomenet korruptive dhe pasojat e dëmshme që sjellin pas vetes këto fenomene,

Në pajtim me mandatin e dhënë me Ligjin Kundër Korrupsionit dhe me legjislacionin tjetër sekondar, puna e Departamentit të Hetimeve është përqendruar në theks të veçantë në këto drejtime:

1. Zbatimi i ligjit, ku hyn:
 - a) Zhvillimi i hetimeve për rastet e dyshuara për korrupsion,
 - b) Bashkëpunimi me institucionet tjera të kyçura në luftën kundër korrupsionit;
2. Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit, ku hyn:
 - a) Përgatitja dhe aprovimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit,
 - b) Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit
3. Kompletimi i legjislacionit dhe edukimi, ku hyn:
 - a. Përgatitjen e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit;
 - b. Edukimin – ngritjen e vetëdijes së publikut për fenomenin e korrupsionit dhe pasojat negative të tij.

1. ZBATIMI I LIGJIT

a. Zhvillimi i hetimeve

Departamenti i Hetimeve për periudhën raportuese, prioritet ka pasur hetimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit, si ato që janë raportuar, po ashtu edhe hetimin e rasteve sipas detyrës zyrtare kur Agjencia ka ardhur deri te informacionet e bazuara për veprime korruptive të dyshuara.

Për sa i takon rasteve të raportuara në lidhje me dyshimin për veprime korruptive, hetimin dhe procedimin e tyre në prokuroritë publike kompetente gjatë kësaj periudhe raportuese, në vijim do të japim pasqyrën e përgjithshme.

Rastet e raportuara në AKK për vitin 2009

AKK për periudhën raportuese, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ka pranuar numër dukshëm më të madh të rasteve të dyshuara për veprime korruptive. Përderisa në vitin 2008 ishin raportuar gjithsejtë 130 raste, gjatë vitit 2009 AKK ka pranuar 175 raste, që në përqindje i bie të jenë pranuar 34.61% më shumë raste se në vitin paraprak.

Kjo dëshmon për rritjen e besimit të qytetarit për punën e AKK-së dhe ngritjen e vetëdijes për raportimin e rasteve të korrupsionit. Për këtë qëllim, AKK ka punuar vazhdimisht duke eliminuar barrierat burokratike si dhe duke thjeshtësuar procedurën e raportimit dhe pranimit të rasteve.

Struktura e rasteve të hetuara për veprime korruptive për vitin 2009

Departamenti i Hetimeve i AKK-së, ka pranuar raste të raportuara nga qytetarët të cilët kanë pretenduar se kanë qenë viktimë të veprimeve korruptive të zyrtarëve publike, si dhe ka ndërmarr veprime hetimore sipas detyrës zyrtare. Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2009 janë evidentuar 175 raste të dyshuara për veprime korruptive në institucionet publike të Kosovës.

Në mesin e personave të dyshuar janë të evidentuar persona zyrtar si dhe persona zyrtarë të lartë të institucioneve publike të kategorizuar me Ligjin Kundër Korrupsionit Nr 2004-34, ku struktura e tyre është si në vijim:

- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara sipas detyrës zyrtare ku të dyshuar kanë qenë gjyqtar dhe staf tjetër i ***Gjykatave të Republikës së Kosovës*** (Gjykatat e Rregullta dhe të kundërvajtjes) janë evidentuar 53 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e ***Institucioneve Tjera***, (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergetike e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish- Ndërmarrjet Shoqërore Doganat e Kosovës, ish Trupat Mbrojtëse të Kosovës etj), si të dyshuar për veprime korruptive janë të evidentuar 43 raste.
- Nga rastet e raportuara si dhe ato të hetuara për veprime korruptive të zyrtarëve në kategorinë e zyrtarëve publik të ***Oeverisë së Republikës së Kosovës*** (ministritë si dhe agjencitë që veprojnë në kuadër të ministrive të caktuara) për periudhën raportuese, janë evidentuar 34 raste.
- ***Pushteti Lokal*** (Komunat e Republikës së Kosovës), përkatësisht personat zyrtar të nivelit lokal si të dyshuar për veprime korruptive, për periudhën raportuese janë evidentuar 31 raste.
- ***Prokuroritë e Republikës së Kosovës*** funksionojnë në tri nivele: Prokuroria Publike Komunale (7 prokurori), Prokuroria Publike e Qarkut (5 prokurori), Prokuroria Publike e Republikës së Kosovës dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës. Sa i përket rasteve të raportuara apo të hetuara sipas detyrës zyrtare, është specifike se krahasuar me vitin e kaluar, gati është trefishuar numri i rasteve të raportuara për këtë kategori. Deri sa në vitin

paraprak raportues kemi pasur 5 raste të evidentuara kundër prokurorëve të prokurorive publike, për periudhën raportuese janë evidentuar 14 raste të dyshuara për veprime korruptive.

Këto të dhëna të paraqitura në mënyrë grafike duken si në vijim:




Fig. 1. Pasqyra e rasteve të raportuara në AKK për periudhën Janar - Dhjetor 2009

Rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente

AKK gjatë periudhës raportuese pas informacioneve të marra nga qytetarët por edhe informacioneve të siguruara sipas detyrës zyrtare, ka zhvilluar procedurën e hetimeve në lidhje me dyshimet për veprime korruptive të zyrtarëve publikë. Rastet për të cilat ka arritur të provojë pretendimet faktike me provat e mbledhura gjatë fazës së hetimeve, i ka proceduar në Prokuroritë Publike kompetente të Kosovës dhe Prokurorinë e EULEX-it 68 informata. Krahasuar me vitin paraprak, kur ishin proceduar 53 informata, kjo përbën një rritje prej 15 informatave të proceduara, që në përqindje i bie të jetë 28%. Struktura e tyre është si në vijim:

- Numri i rasteve të hetuara që i referohen personave zyrtarë të dyshuar si të implikuar në veprime korruptive që vijnë nga **gjykatat**, e që pas mbledhjes së provave janë përcjellë për procedim të mëtejshëm penal në prokuroritë publike kompetente është 18 raste, që krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 63.63% të rasteve të proceduara ku të dyshuar kanë qenë gjyqtarët.
- Rritje të theksuar kanë shënuar numri i rasteve të proceduara në prokuroritë publike kompetente ku të dyshuar kanë qenë **personat zyrtarë të nivelit lokal**, që krahasuar me vitin paraprak (11 raste) për periudhën raportuese janë përcjellë në prokuroritë publike kompetente nga kjo kategori 17 raste të dyshuara për veprime korruptive që paraqet rritje për 54.54 % të rasteve të proceduara.
- Ndaj zyrtarëve të **Qeverisë së Kosovës** (këtu përfshihen edhe ministrinë në kuadër të saj dhe agjencitë të cilat funksionojnë nën ombrellën e qeverisë dhe ministrive), pas hetimeve të zhvilluara dhe kompletimit të dokumentacionit të nevojshëm me provat përkatëse, janë dërguar në prokuroritë publike kompetente për procedim të mëtejshëm 17

raste, që krahasuar me vitin paraprak (16) ka shënuar ngritje të lehtë prej 6.25% të rasteve të dërguara në prokurori.

- Kundër personave zyrtar të **institucioneve tjera publike** (Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Korporata Elektroenergjetike e Kosovës, Hekurudhat e Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ish- Ndërmarrjet Shoqërore, Doganat e Kosovës, ish - Trupat Mbrojtëse të Kosovës etj.), pas hetimeve të zhvilluara dhe mbledhjes së provave në lidhje me dyshimet faktike, janë përcjellë në prokuroritë publike kompetente për procedim penal të mëtejshëm 13 raste të dyshuara për veprime korruptive, që krahasuar me vitin e paraprak nuk ka ndryshuar trendi që paraqet numrin e njëjtë të rasteve të proceduara.
- **Prokuroritë Publike të Republikës së Kosovës** (të tri niveleve) gjatë periudhës raportuese, nga rastet e hetuara pas mbledhjes së provave për vërtetimin e dyshimeve të paraqitura, janë përcjellë në prokuroritë publike kompetente për procedim penal të mëtejshëm 2 raste, që krahasuar me vitin paraprak (2 raste) paraqet numrin e njëjtë të rasteve të proceduara.
- Krahasuar me vitin raportues paraprak kur AKK nuk kishte raste të proceduara në prokurori ku si të dyshuar janë personat zyrtarë të **Kuvendit të Republikës së Kosovës**, këtë vit, pas hetimeve të zhvilluara në lidhje me dyshimet për veprime korruptive dhe mbledhjes së provave, është përcjellë në prokurorinë publike kompetente 1 rast i dyshuar për veprime korruptive.




Fig 2. Numri i rasteve të proceduara në prokuroritë publike kompetente sipas institucioneve Janar 2009–Dhjetor 2009

Personat zyrtar të dyshuar për veprime korruptive

AKK, nga rastet për të cilat ka zhvilluar procedurën e hetimeve dhe për të cilat ka rezultuar me sigurimin e provave, i ka dorëzuar në prokuroritë publike kompetente denoncimet në lidhje me dyshimet për përfshirjen në veprime korruptive për 159 personave zyrtarë të institucioneve të lartpërmendura. Krahasuar me vitin e kaluar ku ky numër ishte 113, del se këtë vit kemi rritje për 46 të personave zyrtar, që në përqindje i bie të jetë 40.7 %.

Informatat e proceduara sipas strukturës së veprave penale

Struktura e veprave penale të proceduara në prokuroritë kompetente, është si në vijim:

- Shpërdorim i detyrës zyrtare dhe autorizimit

Nga numri i përgjithshëm i informatave të proceduara në prokuroritë publike kompetente, numrin më të madh të tyre e përbejnë veprimet korruptive të parapara sipas nenit 339 të Kodit Penal të Kosovës, pra shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit. Sipas figurës së veprës penale në fjalë janë proceduar 38 informata të kësaj natyre. Ndërsa, sipas institucioneve shpërndarja është: 13 Pushteti Lokal, 9 Qeveria, 7 Gjykatat, 6 Institucionet tjera, 2 Prokuroritë dhe 1 Kuvendi i Kosovës.




Fig 3. Shpërdorimi i detyrës zyrtare dhe autorizimit

- Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Veprimet korruptive të dyshuara të cilat janë përcjellë në prokurori për procedim penal të mëtejshëm, që janë karakterizuar si vepër penale të nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore sipas nenit 346 të Kodit Penal të Kosovës, janë tipike për veprimet e gjykatave dhe si të tilla janë përcjellë 10 informata që të gjitha me persona zyrtarë të gjykatave.

- Falsifikim i dokumenteve zyrtare

Gjatë periudhës raportuese njëvjeçare, nga informatat e përcjella në prokuroritë publike kompetente për procedim penal të mëtejshëm, njëra nga veprat penale ka qenë edhe falsifikimi i dokumenteve zyrtare, vepër kjo e paraparë me nenin 348 të Kodit Penal të Kosovës. Ndërsa shpërndarja sipas institucioneve është: Qeveria 3 raste, Institucionet tjera 2 raste, Gjykata 1 rast dhe Pushteti Lokal 1 rast.




Fig 4. Falsifikimi i dokumenteve zyrtare

- Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës

Informatat e përcjella në prokuroritë publike kompetente me dyshimet për veprë penale përvetësim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, sipas nenit 340 të Kodit Penal të Kosovës, janë kryesisht karakteristik për Pushtetin Lokal me 3 raste të kësaj natyre, Institucioneve tjera me 2 raste dhe Qeverisë me 1 rast.




Fig 5. Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës

- Marrje e ryshfetit

Shkeljet e konstatuara gjatë zhvillimit të hetimeve që janë konsideruar si vepra penale marrje e ryshfetit sipas nenit 343 të Kodit Penal të Kosovës, gjatë periudhës raportuese janë përcjellë për procedim penal të mëtejshëm në prokuroritë publike kompetente 5 raste, 4 raste kanë të bëjnë me Qeverinë dhe 1 rast me Institucionet Tjera.




Fig 6. Marrja e rryshfetit

- Lidhja e Kontratës së Dëmshme

Veprimet e dyshuara të kësaj natyre të përcjella në prokuroritë publike kompetente për procedim penal të mëtejshëm për shkak të specifikave të veprës penale - lidhja e kontratës së dëmshme, e paraparë me nenin 237 të Kodit Penal të Kosovës, janë tipike për ndërmarrjet publike të cilat realizojnë të ardhura nga afarizmi i tyre. Prandaj edhe tek rastet e procedura të kësaj natyre kemi të bëjmë me institucionet tjera ku është 1 rast i proceduar në prokurori.

- Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi

Shkeljet e konstatuara gjatë hetimeve të zhvilluara në institucionet publike të Republikës së Kosovës që i përkasin keqpërdorimit të autorizimeve në ekonomi të paraparë me nenin 236 të Kodit Penal të Kosovës, nuk janë prej veprave më tipike të karakterit korruptiv. Por sidoqoftë veprimet e ndërmarra tek veprat penale të korrupsionit zakonisht përmbajnë elementet e më shumë së një vepre penale, andaj edhe specifikat funksionale të institucioneve publike apo edhe subjekteve tjera ekonomike, sidomos tek këto të fundit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, shkelin rregullat e përcaktuara të afarizmit. Gjatë kësaj periudhe raportuese është evidentuar 1 rast i kësaj natyre i cili është përcjellë në prokurori për procedim penal të mëtejshëm e që i takon kategorisë së Institucioneve Tjera.

Karakteristikat e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimeve

AKK ka zhvilluar hetimet në lidhje me dyshimet për veprime korruptive, pra në lidhje me veprat penale nga kreu XXIX i Kodit Penal të Kosovës – Veprat Penale Kundër Detyrës Zyrtare, për shkak se të njëjtat nuk janë të specifikuara si vepra penale të korrupsionit, por që figura e këtyre veprave është tipike me definicionin e korrupsionit që jep Ligji Kundër Korrupsionit.

Raportet e ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të përpiluara në lidhje me fushën e sundimit të ligjit, përkatësisht indeksin e korrupsionit në Kosovë, japin një pasqyrë që veprat penale të korrupsionit përbejnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes por njëkohësisht përbejnë edhe veprat penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime, kjo për shkak të kompleksitetit të veprës penale, mënyrës së kryerjes si dhe kryerësve të këtyre veprave penale.

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me shpërdorimin e detyrës zyrtare është se kjo vepër penale ku janë të përfshirë të gjitha kategoritë e institucioneve në Republikën e Kosovës, karakterizohen me shkelje të ligjit me qëllim përfitimi për vete, shkelje të ligjit me qëllim të shkakimit të demit për personat tjerë apo biznesin e caktuar, tejkalim i kompetencave me qëllim përftimit pasuror për veten ose personat tjerë dhe neglizhimi në përmbushjen e detyrave zyrtare.

Veprimet apo mos veprimet e përmendura i referohen, në rastet më të shpeshta, shkeljes së procedurave të prokurimit ku në mënyrë të hapur dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik, janë dhënë kontrata publike operatorëve ekonomik duke favorizuar të njëjtit, ndërsa që janë eliminuar operatorët ekonomik të cilët i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara me dosjen e tenderit.

Falsifikimi i dokumenteve zyrtare, është prezent tek zyrtarët e Qeverisë, Institucioneve Tjera, Gjykatave dhe Pushtetit Lokal. Gjatë hetimeve janë gjetur prova të cilat tregojnë për falsifikim masiv të dokumenteve zyrtare me qëllim të dhënies së kontratave publike operatorëve ekonomik përkatës, duke përdorur madje edhe emra fiktiv të personelit profesional si dhe duke falsifikuar kontrata të punës me individ të cilët nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar në kuadër të operatorëve përkatës, falsifikimi i raporteve për kryerjen e punëve të cilat në fakt nuk janë kryer ndërsa që është bërë pagesa nga autoritetet kontraktuese. Po ashtu problematike paraqitet edhe çështja e vërtetimeve për kryerjen e obligimeve ndaj shtetit ku janë gjetur se dokumentet e tilla janë falsifikuar në mënyrë të vazhdueshme.

Përvetësimi gjatë ushtrimit të detyrës, gjatë periudhës raportuese, është konstatuar që kryesisht është prezent tek zyrtarët e Pushtetit Lokal, Institucioneve Tjera dhe Qeverisë, ku kryesisht kemi të bëjmë me përvetësimin e mjeteve monetare nga zyrtarët e lartë të këtyre institucioneve që i janë dhënë në menaxhim. Po ashtu, paraqitet sidomos tek pushteti lokal në lidhje me pronën komunale, ku janë evidentuar raste kur e njëjta është dhënë me qira në kundërshtim me ligjin në fuqi, duke mos bërë shpalljen publike ashtu siç e kërkon Ligji për Prokurim Publik. Kjo është bërë me qëllim që këto mjete që merren nga qiraja, të përvetësohen nga zyrtarët publik përkatës.

Marrja e ryshfetit, rezulton që nga 5 rastet e proceduara në prokurori 4 prej tyre i takojnë qeverise dhe 1 institucioneve tjera. Kryesisht ndodhë në lidhje me procedurat e prokurimit, përkatësisht tenderët e shpallur nga këto kategori ku kërkohet ryshfet në këmbim të dhënies së kontratës publike. Rastet e tilla janë konstatuar kur një operator ekonomik është shpallur në aspektin administrativ i pa përshtatshëm për një lot, ndërsa që në këmbim të ryshfetit i njëjti operator ekonomik shpallet fitues për lotin tjetër.

Lidhja e kontratës së dëmshme është prezentë te zyrtarët e Institucioneve Tjera, përkatësisht ndërmarrjet publike të cilat në kontratat publike që i referohen furnizimeve të ndryshme, gjatë hetimeve është vërtetuar që lidhin kontrata më të pa favorshme me operator ekonomik, me dallime më të mëdha në çmime dhe me kualitete të njëjta duke i shkaktuar humbje të konsiderueshme ndërmarrjes.

Në lidhje me veprën penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi, është konstatuar 1 rast që i përket kategorisë së Institucioneve Tjera. Gjatë hetimeve është vërtetuar se organizata e biznesit me qëllim të përfuturit të kundërligjshëm pasuror, ka prezantuar në mënyrë të rreme apo edhe ka fshehur lëvizjen e mjeteve dhe veprimtarisë së saj ekonomike si dhe ka dështuar të paguaj detyrimet tatimore dhe detyrimet tjera fiskale.

Rastet e proceduara sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv

Për periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve AKK ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë dorëzuar për procedim penal të mëtejshëm në prokuroritë publike kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre.

Shpërndarja e tyre sipas vitit të kryerjes është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Nr	INSTITUCIONI	LLOJI I VEPRËS PENALE	VITI
1	Institucionet Tjera	Marrje e ryshfetit	2007
2	Institucionet Tjera	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2006
3	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
4	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2006
5	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
6	Prokuroritë	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2007
7	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2009
8	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
9	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
10	Prokuroritë	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2003
11	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2007
12	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2008
13	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2007
14	Qeveria	Falsifikim i dokumenteve zyrtare	2008
15	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
16	Institucionet Tjera	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
17	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2005
18	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2004
19	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2005
20	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2006
21	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2006
22	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2007
23	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2006
24	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2007
25	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2004
26	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2005
27	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2005
28	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2006
29	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
30	Pushteti Lokal	Përvetësim i pa ligjshëm	2004
31	Pushteti Lokal	Përvetësim i pa ligjshëm	2007
32	Institucionet Tjera	Përvetësim i paligjshëm	2008
33	Pushteti Lokal	Përvetësim i paligjshëm	2009
34	Institucionet Tjera	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2009

35	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
36	Kuvendi i Kosovës	Shpërdorim i detyrës, ushtrim i ndikimit.	2007
37	Pushteti Lokal	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
38	Qeveria	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
39	Gjykatat	Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit	2006
40	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2008
41	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare	2009
42	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare	2007
43	Pushteti Lokal	Shpërdorim i detyrës zyrtare	2006
44	Gjykatat	Nxjerrje e kundërligjshme e vendimit gjyqësor	2004
45	Pushteti Lokal	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
46	Qeveria	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2007
47	Qeveria	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
48	Institucionet Tjera	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
49	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2008
50	Institucionet Tjera	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2008
51	Institucionet Tjera	Lidhje e kontratës dëmshme	2007
52	Pushteti Lokal	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2009
53	Gjykatat	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2006
54	Pushteti Lokal	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
55	Qeveria	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
56	Qeveria	Përvetësim i paligjshëm	2008
57	Qeveria	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2008
58	Institucionet Tjera	Përvetësim i paligjshëm	2009
59	Pushteti Lokal	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
60	Institucionet Tjera	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2009
61	Qeveria	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2009
62	Qeveria	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
63	Qeveria	Marrje e ryshfetit	2009
64	Institucionet Tjera	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2007
65	Qeveria	Falsifikim i Dokumenteve Zyrtare	2006
66	Institucionet Tjera	Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi	2008
67	Pushteti Lokal	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009
68	Institucionet Tjera	Shpërdorim i Detyrës zyrtare ose autorizimit	2009

Tabela 7. Rastet sipas institucioneve konkrete dhe viteve kur kanë ndodhe veprimet korruptive

Rastet e mbyllura

Nga totali i rasteve të paraqitura, pasi janë shqyrtuar paraprakisht, janë zhvilluar hetime në lidhje me rastet përkatëse dhe janë mbyllur 103 raste. Arsyet për mbylljen e tyre janë si vijon:

- 7 raste janë mbyllur për shkak se në pajtim me kornizën ligjore në fuqi Agjencia nuk ka pas kompetencën për hetimin e rasteve të përmendura;
- 73 raste janë mbyllur për shkak se pas zhvillimit të hetimeve në lidhje me këto raste nuk janë gjetur prova më të cilat do të vërtetoheshin pretendimet për veprime korruptive të personave zyrtar;
- 23 raste janë mbyllur për shkak se ka qenë duke u udhëhequr procedurë penale para organeve kompetente.

Rastet anonime të paraqitura në AKK

Në kuptim të nenit 16.2 të Ligjit Kundër Korrupsionit që i referohet personave të cilët me mirëbesim kanë zbuluar informacionin për ekzistencën e korrupsionit dhe me qëllim të pengimit të pasojave të dëmshme ndaj tyre, AKK ka bërë të mundur që qytetarët të paraqesin rastet e dyshuara të korrupsionit në mënyrë anonime me qëllim të ruajtjes së identitetit të raportueseve dhe inkurajimin e qytetarëve për raportimin e këtyre rasteve. Gjatë kësaj periudhe raportuese, numri i rasteve të raportuara në mënyrë anonime dhe atyre të përcjella në prokurori nga kjo kategori është:

- numri i përgjithshëm i informacioneve anonime që ka pranuar Agjencia është 34 raste,
- numri i rasteve anonime të proceduara në prokurorinë publike kompetente është 17 raste.

Pasqyra e përgjithshme e rasteve të trajtuara gjatë vitit 2009

Rastet e trajtuara duke përfshirë rastet e paraqitura, rastet e mbyllura dhe rastet e proceduara në prokuroritë publike kompetente, në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr	INSTITUCIONI	Rastet e paraqitura gjatë vitit 2009	Rastet e bartura nga viti 2008	Rastet e mbyllura	Rastet e përcjellura në Prokurori	Rastet në Procedurë
1	GJKATAT	53	01	30	18	08
2	INSTITUCIONET TJERA.	43	07	27	13	10
3	QEVERIA	34	06	18	17	04
4	PUSHTETI LOKAL	31	05	15	17	03
5	PROKURORITË	14	02	13	02	01
6	PARLAMENTI	0	01	00	01	00
	GJITHËSEJT	175	22	103	68	26

Tabela 8. Pasqyrë e përgjithshme e rasteve të hetuara gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2009

Numri i përgjithshëm i Informatave të proceduara që nga funksionalizimi i AKK-së

AKK që nga funksionalizimi e deri në momentin e raportimit, nga të gjitha rastet e hetuara ku janë gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, i ka proceduar në prokuroritë publike kompetente si dhe prokurorinë e EULEX-it 168 informata. Nga ky numër, prokuroritë kanë dhënë informacion kthyes duke konfirmuar se 60 informata janë në procedurë hetimore, për 5 prej tyre janë ngritur aktakuza, për 5 informata të proceduara është kryer arrestimi i të dyshuarve për veprime korruptive si rezultat i bashkëpunimit në mes AKK-së me prokurorinë publike dhe Policisë së Kosovës, ndërsa për 36 informata është konfirmuar se janë hedhur poshtë, ndërsa për 62 informata të dërguara në Prokuroritë kompetente nuk kemi informata kthyes. Në mënyrë tabelare, këto të dhëna duke si më poshtë:

Nr	Vendi	Lëndët e përcjella	Arrestime	Hetime	Aktakuza	Lëndë të Hedhura	Pa informata kthyesë
1	Prokuroria e Shtetit	02	/	02	/	/	00
2	Prokuroria Publike e Qarkut, Prishtinë	67	2	27	3	6	29
3	Prokuroria Publike e Qarkut, Peje	09	/	/	2	4	03
4	Prokuroria Publike e Qarkut, Gjilan	04	/	/	/	2	02
5	Prokuroria Publike e Qarkut, Prizren	09	/	2	/	7	00
6	Prokuroria Publike e Qarkut, Mitrovicë	05	1	2	/	2	00
7	Prokuroria Publike Komunale, Prishtinë	02	/	2	/	/	00
8	Prokuroria Publike Komunale, Ferizaj	02	/	2	/	/	00
9	Prokuroria Speciale e Kosovës	08	/	1	/	4	03
10	Prokuroria e EULEX-it	34	1	20	/	11	02
11	Policia (e Kosovës, e UNMIK-ut, e EULEX-it)	26	1	02	/	/	23
Totali		168	5	60	5	36	62

Tabela 9: Pasqyra e Informatave të proceduara që nga funksionalizimi i AKK-së

b. Bashkëpunimi me institucionet tjera që kanë mision luftën kundër korrupsionit

AKK ka shtuar angazhimet në fuqizimin e përpjekjeve për forcimin e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj periudhe

raportuese, AKK ka pasur bashkëpunim të shtuar me strukturat ndërkombëtare pra me Komponentën e Drejtësisë së EULEX-it, përkatësisht Prokurorinë e EULEX-it, është intensifikuar bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, me Doganat e Kosovës si dhe me Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Për këtë qëllim, Agjencia ka nënshkruar memorandume të bashkëpunimit me Prokurorinë e EULEX-it, Qendrën e Inteligjencës Financiare, Doganat e Kosovës, Ombudspersonin, Komisionin e Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial. Ndërsa në plan të afërt janë nënshkrimi i memorandumeve edhe me Prokurorinë e Shtetit, Policinë e Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës dhe me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik.

Për periudhën raportuese, është e rëndësishme të përmendet edhe mosbashkëpunimi ose refuzimi për të bashkëpunuar në fushën e luftimit të korrupsionit, përkatësisht mos ofrimin e dokumentacionit të kërkuar në pajtim me nenin 15 të Ligjit Kundër Korrupsionit 2004/34. Kjo ka ndodhur në dy raste ku kemi të bëjmë me Komunën e Prishtinës dhe me Këshillin e Pavarur Gjyqësor të Kosovës, por që në lidhje me këtë, Agjencia ka kërkuar ndihmën e prokurorisë publike dhe këto pengesa janë eliminuar.

2. STRATEGJIA DHE PLANI I VEPRIMIT KUNDËR KORRUPSIONIT

a. Përgatitja dhe aprovimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit

Duke u bazuar në Ligjin Kundër Korrupsionit, AKK në bashkëpunim me institucionet tjera ka përpiluar Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit si dokumente me të cilat parashihen masa konkrete për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Strategjia kundër Korrupsionit

AKK ka filluar me përgatitjen e Strategjisë Kundër Korrupsionit gjatë tre mujorit të parë të vitit 2008, duke iniciuar përgatitjen e konceptit të këtij dokumenti strategjik. Në qershor të vitit 2008 AKK ka organizuar mbledhjen e parë të grupit punues ndër-institucional, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet përgjegjëse.

Duke pasur parasysh nevojën për transparencë dhe në mënyrë që të sigurohej një pjesëmarrje sa më e gjerë, në proces u përfshinë shumë institucione ndër të cilat: Zyra e Kryeministrit, përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë, përfaqësues nga shumica e ministrive, institucionet e pavarura, shoqëria civile, mediat si dhe ekspertë ndërkombëtar. Procesi i përpilimit të tekstit të Strategjisë filloi në muajin prill të vitit 2008. Grupi punues mbajti pesë takime në Prishtinë, ndërsa dokumenti i Projekt-Strategjisë u finalizua gjatë një punëtorie që u mbajt me datën 30 dhe 31 korrik të vitit 2008 në Ohër të Maqedonisë. Strategjia Kundër Korrupsionit është dokument bazë i politikave kundër korrupsionit të Republikës së Kosovës, dhe si i tillë paraqet dokumentin bazë për parandalimin dhe luftimin e Korrupsionit në një periudhë tre vjeçare prej vitit 2009 - 2011.

Strategjia identifikon dhe parashtron sektorët prioritar ku duhet të përqendrohet lufta kundër korrupsionit si dhe objektivat specifike të luftës kundër korrupsionit që duhet të zbatohet çdo institucion i përfshirë në kategorinë e sektorëve prioritar. Strategjia kundër

Korrupsionit është fokusuar në 7 sektor prioritar dhe atë në Sektorin Politik, Qeverisjen Lokale, Administratën Qendrore Publike, Agjencitë Monitoruese të zbatimit të Ligjit dhe Gjyqësori, Financat Publike dhe Menaxhimi i tyre, Sektorin Privat/ Veprimet e Biznesit dhe Shoqërinë Civile, ndërsa një kapitull i veçantë i është kushtuar Bashkëpunimit Ndërkombëtar.

AKK dokumentin final të Strategjisë Kundër Korrupsionit e ka dërguar për aprovim në Qeveri në shtator të vitit 2008 e cila përmes Qeverisë është proceduar për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e parë plenare nuk e ka miratuar Strategjinë kundër Korrupsionit më arsyetimin se të njëjtës i mungon Plani i Veprimit. Duke e pasur parasysh këtë fakt, AKK në bashkëpunim me institucionet tjera e ka përgatitur Planin e Veprimit i cili se bashku me Strategjinë me 12 Tetor të vitit 2009, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Plani i Veprimit

Me qëllim të zbatimit të Strategjisë kundër Korrupsionit, AKK e ka iniciuar fillimin e përgatitjes së Planit të Veprimit duke e formuar grupin e brendshëm punues, i cili gjatë dhjetorit të vitit 2008, në bashkëpunim me institucionet tjera, ka filluar me përgatitjen e Planit të Veprimit. Grupi punues i ka mbajtur 16 takime në Prishtinë ku 2 takime janë mbajtur me të gjithë sektorët, ndërsa 14 të tjera janë mbajtur me secilin sektor veç e veç. Ky dokument është finalizuar gjatë një punëtorie të mbajtur më 8 dhe 9 maj të vitit 2009 në Strugë të Maqedonisë.

Plani i Veprimit është dokument i cili përmban në vete objektiva dhe veprime specifike për çdo institucion. Këto veprime janë të natyrës së ndryshme si:

- Veprime për zbatimin e ligjit;
- Veprime parandaluese; dhe
- Veprime për edukimin dhe pjesëmarrjen e publikut.

b. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit

Neni 23 pika c i Ligjit kundër Korrupsionit si dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsionit parasheh se AKK është përgjegjëse për implementimin e Strategjisë kundër Korrupsionit si dhe për monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. AKK përpos monitorimit të zbatimit të veprimeve nga ana e institucioneve, është përgjegjëse edhe për zbatimin e veprimeve të parashikuara nga vetë ajo në Planin e Veprimit.

Për të bërë të mundur implementimin e objektivave dhe veprimeve të parapara në Strategjinë kundër Korrupsionit dhe Planin e Veprimit, AKK ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse të cilat janë direkt përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin e veprimeve përkatëse, që ti caktojnë pikat e kontaktit të cilat do të raportojnë në lidhje me zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

AKK në bashkëpunim me Projektin e Komisionit Evropian për ndihmë institucioneve që merren me parandalimin dhe hetimin e korrupsionit (SACIK) e ka përgatitur matricën për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Me

qëllim të sqarimit të formës së raportimit, AKK gjatë muajit nëntor dhe dhjetor të vitit 2009, i ka mbajtur 3 trajnime me të gjitha pikat kontaktuese të institucioneve përgjegjëse.

Bazuar në këtë, AKK me datë 06.01.2010 i është drejtuar me shkresa zyrtare të gjithë Sekretarëve të Përhershëm të Ministrive, titullarëve të sektorëve të tjerë si dhe pikave të kontaktit të cilat kanë qenë të përfshira në Planin e Veprimit, se deri me datë 15.01.2010 ti dorëzojnë në AKK raportet për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe të bëjnë rishikimin e objektivave dhe veprimeve të paraqitura në Planin e Veprimit.

Në procesin e raportimit kanë qenë të përfshira 41 subjekte duke i përfshirë këtu institucionet publike qendrore dhe lokale, sektorin privat si dhe shoqërinë civile, 38 nga të cilat i kanë dorëzuar raportet sa i përket zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit që në përqindje i bie të kenë raportuar 92.11% të subjekteve. Më poshtë, në mënyrë tabelare janë të paraqitura institucionet të cilat kanë raportuar.

Nr	SUBJEKTET	RAPORTIMI	
		PO	Jo
SEKTORI POLITIK			
1.	Zyra e Kryeministrit	PO	
2.	Ministria e Administratës Publike	PO	
QEVERISJA LOKALE			
3.	Ministria e Pushtetit Lokal	PO	
4.	Asociacioni i Komunave	PO	
ADMINISTRATA PUBLIKE QENDRORE			
5.	Ministria e Energjisë dhe Minierave	PO	
6.	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	PO	
7.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	PO	
8.	Ministria e Punëve të Brendshme	PO	
9.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	PO	
10.	Ministria e Ekonomisë dhe Financave	PO	
11.	Ministria e Shëndetësisë	PO	
12.	Ministria e Administratës Publike	PO	
13.	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit	PO	
14.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	PO	
15.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	PO	
16.	Ministria e Drejtësisë	PO	
17.	Ministria e Punëve të Jashtme	PO	
18.	Ministria për Komunitete dhe Kthim	PO	
19.	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	PO	
20.	Administrata Tatimore e Kosovës	PO	
AGJENSITE MONITORUESE TE ZBATIMIT TE LIGJIT DHE GJYQESORI			
21.	KRPP-ja	PO	

22.	Prokuroria Publike e Kosovës	PO	
23.	Ombudspersoni	PO	
24.	Policia e Kosovës	PO	
25.	Inspektoriati Policor	PO	
26.	Auditori Gjeneral	PO	
27.	Instituti Gjyqësor i Kosovës	PO	
28.	Agjencia kundër Korrupsionit	PO	
29.	Zyra e Kryeministrit	PO	
FINANCAT PUBLIKE DHE MENAXHIMI I TYRE			
30.	Agjencia Kosovare e Privatizimit	PO	
31.	Banka Qendrore e Kosovës	PO	
32.	KEK-u	PO	
33.	Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit	PO	
34.	Dogana e Kosovës	PO	
SHOQERIA CIVILE			
35.	Agjencioni i Gazetarëve Profesionist të Kosovës	PO	
36.	KDI	PO	
37.	ÇOHU	PO	
BASHKËPUNIMI NDERKOMBËTAR			
38.	Agjencia kundër Korrupsionit	PO	

Tabela 10. Pasqyra e Institucioneve që kanë raportuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Ndërsa 3 prej subjekteve të përfshira në këtë raportim nuk kanë raportuar fare për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, edhe pse AKK ju ka ofruar disa afate shtesë si dhe ka qenë gjithmonë e gatshme për bashkëpunim. Në përqindje i bie të mos kenë raportuar 7.89% të subjekteve.

Më poshtë në mënyrë tabelare janë paraqitur subjektet të cilat nuk kanë raportuar.

Nr	SUBJEKTET	RAPORTIMI	
		PO	Jo
Agjencitë monitoruese të zbatimit të ligjit dhe Gjyqësori			
1.	Këshilli Gjyqësor i Kosovës - KGJK		JO
SEKTORI PRIVAT/VEPRIMET E BIZNESIT			
2.	Aleanca Kosovare e Bizneseve		JO
SHOQERIA CIVILE			
3.	Organizata Joqeveritare INPO		JO

Tabela 11: Pasqyra e Institucioneve që nuk kanë raportuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit

3. KOMPLETIMI I LEGJISLACIONIT DHE EDUKIMI

a. Përgatitja e propozimeve për plotësimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit

Në përmbushje të mandatit ligjor të përcaktuar me Ligjin kundër Korrupsionit, AKK gjatë periudhës raportuese ka dhënë një kontribut të çmuar në plotësimin e kuadrit ligjor kundër korrupsionit, sikurse edhe në segmente tjera që kanë lidhje indirekte me këtë fushë.

AKK në mënyrë aktive u angazhua në lidhje me Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Kundër Korrupsionit, Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik duke marrë pjesë në grupet punuese ndërqeveritare si dhe ka dhënë kontribut të çmueshëm gjatë shqyrtimit të këtyre ligjeve në Komisionin Parlamentar për Legjislacion dhe Gjqësi, në të gjitha fazat e shqyrtimit të tij deri në aprovimin përfundimtar të tyre. Këto dy ligje janë miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të njëjtat janë dekretuar nga ana e Presidentit të Republikës së Kosovës.

Po ashtu AKK ka marrë pjesë edhe në përgatitjen e Projektligjit për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë, duke marrë pjesë në grupet punuese ndërqeveritare si dhe në Komisionin Parlamentar për Legjislacion dhe Gjqësi, i cili projektligj tashmë është aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

AKK ka dhënë kontributin e vetë, përmes komenteve profesionale, rekomandimeve konkrete si dhe duke marrë pjesë në grupet punuese gjatë amandamentimit të Kodit Penal të Kosovës sidomos sa i përket veprave penale kundër detyrës zyrtare, duke propozuar ndryshimin e veprave aktuale, shtimin e veprave të reja si dhe ashpërsimin e sanksioneve penale për këto vepra penale.

Zyrtaret e AKK-së në mënyrë aktive ishin pjesëmarrës në takimin e nëngrupit qeveritar për anti-korrupsion në kuadër të Reformës së Administratës Publike të Kosovës të organizuar nga Ministria e Administratës Publike.

Me ftesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme, AKK ka marrë pjesë duke dhënë kontributin e saj edhe në përgatitjen e Strategjisë kundër Krimit të organizuar si dhe Strategjisë për Parandalimin e Krimit.

Për ti dhënë mbështetje AKK-së në ngritjen e kapaciteteve profesionale në gjitha departamentet e tij, Komisioni Evropian ka përkrahur projektin "Mbështetja për Institucionet Kundër Korrupsionit në Kosovë", SACIK. Projekti synon që përmes trajnimeve të ndryshme të ndihmojë AKK-në në ngritjen e kapaciteteve profesionale në hetime, parandalim, legjislacion dhe edukim.

Gjithashtu AKK ka marrë pjesë në shumë takime me karakter vendor dhe ndërkombëtar. Këtu përfshihen takimet më përfaqësuesit e Projektit të Komisionit Evropian për ndihmë Institucioneve të cilat merren më luftimin e korrupsionit (SACIK), takimet më përfaqësuesit e OSBE-së si dhe pjesëmarrja në konferencat rajonale dhe ndërkombëtare të cilat kanë pasur si qëllim rritjen e bashkëpunimit të institucioneve të cilat merren më parandalimin dhe hetimin e korrupsionit siç janë konferencat e organizuara në Prishtinë, Oslo të Norvegjisë, Sofie të Bullgarisë, Doha të Katarit, Seul të Koresë Jugore, Paris të Francës etj.

Me qëllim të implementimit të mandatit ligjor dhe funksionalizimit më të madh të AKK-së, gjatë periudhës raportuese AKK ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm në drejtim të përgatitjes së akteve të brendshme, ku në këtë aspekt janë nxjerr 6 Vendime të brendshme.

- b. Edukimi – ngritja e vetëdijes së publikut për fenomenin e korrupsionit dhe pasojat negative të tij

Me qëllim të sensibilizimit të opinionit të gjerë, qytetarëve dhe institucioneve për pasojat e shumta negative të korrupsionit, AKK gjatë periudhës raportuese, me ndihmën dhe përkrahjen e UNDP-së dhe OSBE-së, ka organizuar nëpër komunat e Kosovës fushatën kundër korrupsionit të titulluar “ Përpjekjet e përbashkëta për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë” e cila ka pasur si qëllim kultivimin e frymës së bashkëpunimit me qytetarët në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Kjo fushatë është mbajtur në 14 komuna në nivel vendi, e konceptuar në atë mënyrë që janë mbajtur debate me zyrtaret e këtyre institucioneve në të gjitha nivelet. Në këto debate kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Policisë, Prokurorisë, Gjykatave, mediave, OJQ-ve, etj, ku është debatuar në lidhje me mënyrën e bashkëpunimit, raportimit të rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe domosdoshmërinë e fuqizimit të përpjekjeve për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Përveç kësaj, AKK ka marrë pjesë edhe nëpër shumë debate të organizuara nga institucionet e tjera publike si dhe organizatat joqeveritare të cilat si qëllim kryesor kanë pasur vetëdijesimin e qytetarëve në lidhje me pasojat që shkakton korrupsioni në mirëqenien e tyre.

VI. PARANDALIMI I KORRUPSIONIT

Aktivitetet në fushën e parandalimit të korrupsionit kryhen nga Departamenti i Parandalimit të AKK-së.

Përgjegjësitë ligjore të Departamentit të Parandalimit janë:

- Ushtrimi i kompetencave të Agjencisë në fushën e konfliktit të interesave, pranimit të dhuratave dhe mbikëqyrjes së pasurive;
- Përgatitja e paralajmërimeve për personat zyrtar sipas nenit 29.1 të Ligjit Kundër Korrupsionit;
- Mbledhja e të dhënave për personat që kanë detyrimin për deklarim;
- Përgatitja e Propozimeve për fillimin e procedurës për shkarkim të personave zyrtar nga organi kompetent sipas nenit 29.2 të Ligjit Kundër Korrupsionit,
- Propozimi për publikimin në Gazetën Zyrtare të subjekteve që për shkak të shkeljeve të Ligjit Kundër Korrupsionit përjashtohen për një kohë të caktuar nga pjesëmarrja në tenderët publikë në territorin e Kosovës;
- Përgatitja e formës dhe përmbajtjes së katalogut (standard) të dhuratave që mbahen nga organet e administratës publike;

- Përgatitja e listës për evidentimin e dhuratave që janë në ruajtje të organeve të administratës publike;
- Përgatitja e Formularit të posaçëm të deklarimit të pasurive i cili përmban informacionet e parashikuara nga nenet 40 dhe 41 të Ligjit Kundër Korrupsionit;
- Përgatitja e listës dhe llojet e dëshmimeve sipas nenit 41.3 të Ligjit Kundër Korrupsionit që personi zyrtar duhet të vëre në dispozicion,
- Përgatitja e paralajmërimeve për personat zyrtar sipas nenit 43.1 të Ligjit Kundër Korrupsionit;
- Përgatitja e Propozimeve për fillimin e procedurës për shkarkim të personave zyrtar nga organi kompetent sipas nenit 43.4 Ligjit Kundër Korrupsionit;
- Përgatitja e pjesës së Raportit që ka të bëjë me mbikëqyrjen e pasurive, konfliktin e interesave dhe pranimin e dhuratave;
- Përmbushja e detyrave tjera në përputhje me mandatin e këtij departamenti.

Mandati ligjor i Departamentit të Parandalimit është i bazuar në tri shtylla:

1. Mbikëqyrjen e pasurisë dhe kontrollin
2. Mbikëqyrjen e dhuratave dhe
3. Parandalimin e konfliktit të interesit.

1. MBIKËQYRJA E PASURISË DHE KONTROLLI

a. Mbikëqyrja e pasurisë

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit kundër Korrupsionit, formularët e plotësuar duhet të dorëzohen në AKK deri më 31 mars, për vitin paraprak. Numri i zyrtarëve të lartë të cilët kanë pasur për obligim të deklarojnë pasurinë e tyre në vitin 2009 ka qenë 800. Nga numri i përgjithshëm i tyre 619 apo 77.37% e kanë deklaruar pasurinë, ndërsa 173 është numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë në afatin e parë. 8 (tetë) të tjerë janë zyrtarë të lartë që janë liruar nga detyra që kanë ushtruar më herët, dhe nuk bartin detyrim për deklarimin e pasurisë

Caktimi i pikave kontaktuese

Për një efikasitet më të madh në punë, dhe në funksion të zbatimit të ligjit, AKK ka caktuar pikat kontaktuese nëpër institucionet e Republikës së Kosovës.

AKK gjatë muajit shkurt ka përgatitur një trajnim me pikat kontaktuese. Qëllimi i trajnimit ka qenë përgatitja e zyrtarëve nga pikat kontaktuese për detyrat dhe obligimet që kanë konform ligjit në fuqi, mënyra e plotësimit të formularëve për deklarim të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe dorëzimi i tyre në Agjenci.

Përgatitja e listave për zyrtarët e lartë dhe shpërndarja e formularëve

AKK ka kërkuar nga institucionet gjegjësisht nga pikat kontaktuese përgatitjen e listave për zyrtarët e lartë bazuar në nenin 2 të LKK-së. Pas pranimin të listave nga institucionet e Republikës së Kosovës, AKK ka përgatitur formularët për deklarim të pasurisë dhe dhuratave konform nenit 39 të LKK-së në të cilin thuhet se Agjencia mbikëqyr pasurinë e

personave zyrtar të lartë në bazë të informacionit të dorëzuar nga personi zyrtar i lartë në një formular të posaçëm, i cili është përcaktuar nga AKK.

Deklarimi i pasurisë në afatin e parë

Lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të deklarimit të pasurisë deri më 31 mars 2009, kemi tabelën e mëposhtme, ku jepen në mënyrë të detajuar përqindjet e zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë, të ndara në bazë të institucioneve.

Nr	Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Numri i zyrtarëve të shkarkuar nga detyra të cilët tani nuk kanë obligim për ta deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
1	Kuvendi	123	0	74	49	60.1
2	Presidenca	4	0	4	0	100
3	Qeveria	282	8	212	62	77.3
4	Gjykatat	296	0	239	57	80.7
5	Prokuroria	95	0	90	5	94.7
	Totali	800	8	619	173	78.1

Tabela 12: Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarimin e pasurisë deri më 31 mars 2009

Deklarimi i pasurisë në afatin e dytë

Në pajtim me nenin 43.1 të LKK-së, nëse zyrtari i lartë nuk dorëzon informacionin e referuar në nenin 41 dhe 42 të LKK-së brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj, AKK nxjerr një paralajmërim dhe vendos një afat të ri i cili nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 ditë nga dita e nxjerrjes së paralajmërimit.

Bazuar në këtë, AKK pas verifikimit të listave të zyrtarëve të cilët nuk kishin dorëzuar formularët për deklarim të pasurisë deri më 31 mars, nxori një paralajmërim me datë 03 prill 2009 dhe vendosi një afat të ri për dorëzimin e formularëve. Afati i ri i vendosur nga AKK përcaktonte datën 30 prill 2009, si afati i fundit ligjor për dorëzimin e formularëve të deklarimeve. Numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë deri me këtë datë arrin në 776 apo 97.9 %.

Lidhur me gjendjen e përgjithshme të procesit të deklarimit të pasurisë deri më 30 prill 2009, tabela e mëposhtme jep në mënyrë të detajuar numrin dhe përqindjet e zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë, të ndara në bazë të institucioneve.

Nr	Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë të obliguar për deklarimin e pasurisë	Numri i zyrtarëve të shkarkuar nga detyra të cilët tani nuk kanë obligim për ta deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve të lartë që kanë deklaruar pasurinë	Numri i zyrtarëve që nuk e kanë deklaruar pasurinë	Përqindja e deklarimit (%)
1	Kuvendi	123	0	121	2	98.3
2	Presidenca	4	0	4	0	100
3	Qeveria	282	8	270	4	98.5
4	Gjykatat	296	0	287	9	96.9
5	Prokuroria	95	0	94	1	98.9
	Totali	800	8	776	16	97.9

Tabela 13. Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarimin e pasurisë deri më 30 prill 2009

Shqiptimi i masës administrative ndaj zyrtarëve që nuk kanë deklaruar pasurinë

Në rastet kur zyrtari i lartë nuk dorëzon informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në ligj, AKK informon organin ku zyrtari i lartë ushtron detyrën e tij dhe në pajtim me paragrafin 3 të nenit 43 të LKK-së, kërkon që paga ose shpërblimi i pagës të zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj (kjo masë administrative zgjat 3 muaj), derisa në AKK të merret njoftimi se zyrtari i lartë ka dorëzuar informacionin e kërkuar. Numri i zyrtarëve të lartë ndaj të cilëve është kërkuar që të merret kjo masë administrative ka qenë 16.

Emrat e Zyrtarëve të Lartë të cilët nuk e kanë deklaruar Pasurinë në vitin 2009 dhe ndaj të cilëve është kërkuar që paga ose shpërblimi i pagës të zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj janë të dhënë në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Pozita e zyrtarit
1	Elheme Hetemi	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Deputete
2	Mihailo Shqepanoviç	Kuvendi i Republikës së Kosovës	Deputet
3	Elez Hoxha	Gjykata e Qarkut Prishtinë	Gjyqtar
4	Drita Hoxha	Gjykata e Qarkut Prishtinë	Gjyqtare
5	Bedri Krasniqi	Gjykata e Qarkut Prishtinë	Gjyqtar
6	Sudan Gorani	Gjykata e Qarkut Pejë	Gjyqtar
7	Demush Krasniqi	Gjykata Komunale Malishevë	Gjyqtar
8	Zlatica Vukasinoviç	Gjykata Komunale Lepasaviq	Kryetare e Gjykatës
9	Snezhana Kostić	Gjykata Komunale Lepasaviq	Gjyqtare
10	Zoran Paviç	Gjykata Komunale Lepasaviq	Gjyqtar
11	Tatjana Virijeviç	Gjykata Komunale për Kundërvajtje Lepasaviq	Kryetare e Gjykatës
12	Slobodan Stefanoviç	Prokuroria Komunale Gjilan	Prokuror
13	Ismet Abdullahu	Ministria e Shëndetësisë SH.SH.M.B Ferizaj	Drejtor

14	Skender Kandiçi	Ministria e Shëndetësisë SH.SH.M.B Pejë	Drejtor
15	Mahmud Lilaj	Ministria e Shëndetësisë SH.SH.M.B Gjakovë	Drejtor
16	Rudina Bukoshi	Ministria e Punëve të Jashtme	Drejtoreshë

Tabela 14. Lista e zyrtarëve ndaj të cilëve është kërkuar masa e zvogëlimit të pagës

Kërkesa për fillimin e procedurës për shkarkim nga detyra

Edhe pas shqiptimit të masës administrative që paga ose shpërblimi i pagës të zvogëlohen me 1/5 për çdo muaj (kjo masë administrative zgjat 3 muaj), 6 (gjashtë) zyrtar të lartë nuk e kanë përmbushur këtë obligim ligjor. AKK konform nenit 43.5 ka kërkuar që të fillojë procedura për shkarkim nga detyra dhe për këtë institucioni ta informojë AKK për vendimin final.

Emrat e zyrtarëve të lartë të cilët nuk e kanë deklaruar pasurinë në vitin 2009 dhe ndaj të cilëve është kërkuar që të fillojë procedura për shkarkim nga detyra janë të dhënë në tabelën e mëposhtme.

Nr	Emri dhe mbiemri i zyrtarit të lartë	Institucioni	Pozita e zyrtarit
1	Mahmud Lilaj	Ministria e Shëndetësisë SH.SH.M.B Gjakovë	Drejtor
2	Demush Krasniqi	Gjykata Komunale Malishevë	Gjyqtar
3	Snezhana Kostiq	Gjykata Komunale Leposaviq	Gjyqtare
4	Slobodan Stefanoviç	Prokuroria Komunale Gjilan	Prokuror
5	Zlatica Vukasinoviç	Gjykata Komunale Leposaviq	Kryetare e Gjykatës
6	Sudan Gorani	Gjykata e Qarkut Pejë	Gjyqtar

Tabela 15. Lista me emrat e zyrtarëve të lartë për të cilët është kërkuar shkarkimi nga detyra.

Pas kërkesës së AKK-së për ndërmarrjen e kësaj mase, gjashtë (6) zyrtarët e lartë kanë bërë deklarin e pasurisë së tyre, dhe kanë dorëzuar formularin për deklarin në Agjenci.

Obligimi i zyrtarëve të ri në institucione për deklarin të pasurisë

Institucionet e Kosovës i kanë raportuar AKK-se ndryshimet e listave të zyrtarëve të lartë. Janë evidentuar 30 zyrtarë të lartë, të rinjë të cilët konform LKK-së kanë qenë të obliguar të bëjnë deklarin e pasurisë së tyre. Nga këta zyrtar, 16 prej tyre kanë deklaruar pasurinë, ndërsa 14 të tjerë janë në proces të deklarin.

Deklarimi i pasurisë nga zyrtarët e AKK-së

Është obligim ligjor që edhe zyrtarët e Agjencisë, ta bëjnë deklarin pasurisë. Të gjithë zyrtarët e AKK-së (35 sa janë gjithsejtë) kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

b. Kontrollimi i Formularëve për Deklarim të Pasurisë

Kontrolli tekniko/logjik

Gjatë periudhës kohore prej datës 15.06.2009 deri më 30.06.2009 AKK ka përfunduar procesin e kontrollit tekniko/logjik të 800 (tetëqind) formularëve për deklaram të pasurisë.

Pas kontrollit tekniko/logjik të formularëve të dorëzuar nga zyrtarët e lartë, rezulton kjo gjendje:

- 376 apo 47% të formularëve kanë mungesa në mënyrë të plotësimi,
- 25 apo 3.1% të formularëve nuk kanë të deklaruar numrin personal,
- 130 apo 16.2% të formularëve nuk kanë të deklaruar funksionet aktive,
- 8 apo 1% të formularëve nuk kanë të deklaruar përbërjen familjare,
- 14 apo 1.7% të formularëve nuk kanë të deklaruar pasurinë e paluajtshme,
- apo 5.8% të formularëve nuk kanë të deklaruar paratë e gatshme të mbajtura nëpër institucione bankare,
- 83 apo 10.3% të formularëve nuk kanë të deklaruar të hyrat vjetore,
- 69 apo 8.6% të formularëve kanë të deklaruar se nuk ka ndryshime nga viti i kaluar.

Lidhur me plotësimin tekniko/logjik të formularit për deklarimit të pasurisë në tabelën e mëposhtme jepen të dhënat në mënyrë të detajuar, sipas institucioneve.

Nr	Institucionet	Numri i personale	Funksionet aktive	Përbërja familjare	Pasuria e paluajtshme	Paratë gatshme	Të hyrat vjetore	Njëjtë me vitin e kaluar	Gjithsej
1	Kuvendi	4	6	2	4	8	14	16	54
2	Presidenca	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Qeveria	10	72	4	6	14	33	13	152
4	Gjykatat	7	37	0	0	18	20	34	116
5	Prokuroria	4	15	2	4	7	16	6	54
	Totali	25	130	8	14	47	83	69	376
	Përqindja e totalit	3.1%	16.2%	1%	1.7%	5.8%	10.3%	8.6%	47%

Tabela 16: Pasqyrë e përgjithshme mbi kontrollin tekniko/logjik të formularëve.

Kontrolli i plotë

AKK gjithashtu edhe këtë vit ka vazhduar me kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë së zyrtarëve të lartë. Fillimisht kemi bërë krahasimin e formularëve të pasurisë në mes të viteve 2007-2008 me atë të vitit 2009. Ky kontroll është bërë për të gjithë zyrtarët e lartë me përjashtim të zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë. Nga kontrolli i bërë kemi hasur në disa paqartësi në mes formularëve për deklarim të pasurisë të 20 zyrtarëve të lartë, dhe në vazhdimësi AKK është duke kërkuar sqarime nga zyrtarët e lartë lidhur me të dhënat e deklaruara në formular.

Zyrtarët që kanë deklaruar se ushtrojnë edhe funksione tjera

Gjatë kontrollit të formularëve për deklarim të pasurisë dhe dhuratave AKK ka evidentuar 39 zyrtar të lartë, që kanë deklaruar se kryejnë edhe funksione tjera, krahas funksionit zyrtar. Nga 39 zyrtar të lartë, 21 janë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, 17 janë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe 1 nga Prokuroria Publike e Republikës së Kosovës. Këtë listë me emra të zyrtarëve të lartë AKK e ka trajtuar me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

Bashkëpunimi me institucionet

Gjatë viti 2009, AKK ka shtuar bashkëpunimin edhe me institucionet tjera që kanë për mision parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe me institucionet relevante që mund të na ofrojnë të dhënat e nevojshme për parandalimin e korrupsionit.

Me qëllim të ushtrimit të një kontrolli më të detajuar për zyrtarët e lartë, gjatë vitit 2009, kemi përsëritur kërkesën tonë 9 komunave të Republikës së Kosovës për informacionet lidhur me pasurinë e paluajtshme të zyrtarëve të lartë.

Po ashtu AKK ka kërkuar informacione nga Qendra Inteligjente Financiare lidhur me xhirollogaritë bankare për kabinetin qeveritar, mirëpo ky institucion nuk ka ofruar informacionet e kërkuara. Gjithashtu me një shkresë ju kemi drejtuar edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me ofrimin e një data-baze elektronike të regjistrimit të automjeteve prej datës 01 shtator deri më 30 prill 2009. Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka ofruar informacionet e kërkuara me arsyetimin se qasja në këto të dhëna është e kufizuar dhe me legjislacion në fuqi, lejohet vetëm për organet e hetuesisë.

2. MBIKËQYRJA E DHURATAVE

a. Katalogu i Dhuratave

Sipas nenit 35 të LKK-së, të gjitha institucionet janë të detyruara të mbajnë katalogun e dhuratave dhe ti dërgojnë kopjet e katalogëve për vitin paraprak në AKK jo më vonë se dita e fundit e marsit të vitit vijues për vitin paraprak.

Procedura e mbajtjes së katalogut të dhuratave dhe dorëzimit të tij në AKK

Në vitin 2009, 4 (katër) nga 21 (njëzetënjë) institucione sa kanë pasur për obligim të evidentojnë dhuratat për vitin paraprak, kanë sjell sipas afatit ligjor, kopjet e katalogut të dhuratave. Ndërsa institucionet tjera, kanë njoftuar me shkrim se zyrtarët e tyre nuk kanë pranuar asnjë dhuratë gjatë vitit paraprak.

Institucionet të cilat kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave për vitin 2008 janë: Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës (24 dhurata formale), Kuvendi i Republikës së Kosovës (16 dhurata formale), Ministria e Forcës së Sigurisë (1 dhuratë rasti) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (5 dhurata formale).

Të dhënat lidhur me deklarinimin e dhuratave nga 21 institucionet qendrore të Republikës së Kosovës, janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Nr	Institucionet	Dhuratat e deklaruar	Formale	Të rastit
1	Kuvendi	16	16	0
2	Presidenca	24	24	0
3	Qeveria	6	5	1
4	Gjykatat	0	0	0
5	Prokuroria	0	0	0

Tabela 17. Pasqyrë e përgjithshme mbi deklarinimin e dhuratave.

Shpërndarja e katalogut të dhuratave

Në funksion të zbatimit të ligjit që ka të bëjë me pranimin e dhuratave, AKK ka kërkuar nga të gjitha Agjencitë e pavarura të Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e Republikës dhe Komunitet të Republikës së Kosovës të caktojnë nga një zyrtar kontaktues në institucionin e tyre për regjistrimin dhe mbajtjen e Katalogut të Dhuratave. Këto institucione kanë bashkëpunuar me AKK-në dhe kanë caktuar zyrtarin kontaktues, ku të njëjtën gjë e kanë bërë edhe 25 Komuna të Republikës së Kosovës.

Institucionet që nuk kanë bashkëpunuar me AKK-në

Gjatë periudhës raportuese janë evidentuar 5 komuna të Republikës së Kosovës që nuk kanë bashkëpunuar me AKK-në edhe pas dërgimit të shkresës së dytë. Ato janë: Komuna e Ferizajt, Leposaviqit, Zubin Potokut, Zveqanit dhe Shtërpçës.

Trajnimi me pikat kontaktuese

AKK ka mbajtur trajnim me të gjithë zyrtarët e caktuar për herë të parë si pika kontaktuese. Qëllimi i trajnimit ka qenë ofrimi i njohurive për mënyrën e mbajtjes dhe regjistrimin e dhuratave në katalogun e dhuratave nëpër institucionet e Republikës së Kosovës. Gjithashtu jemi në proces për caktimin e pikave kontaktuese nëpër institucionet e sapo themeluara.

3. PARANDALIMI I KONFLIKTIT TE INTERESIT

a. Baza ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit

Baza ligjore në të cilën e AKK e mbështet punën e vet për parandalimin e konfliktit të interesit është Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik nr.02/L-133 i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në nëntor 2007 si dhe me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-133 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, nr. 03/L-155.

AKK për parandalimin e konfliktit të interesit ka zhvilluar aktivitetin e vet që për qëllim ka pas identifikimin, shqyrtimin, analizën, paralajmërimin dhe shmangien e rasteve të konfliktit të interesit.

Identifikimi i rasteve të konfliktit të interesit

AKK për parandalimin e konfliktit të interesit shfrytëzon edhe formularët e deklarimit të pasurisë. Gjatë kontrollimit të formularëve për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, identifikohen rastet kur vet zyrtarët deklarojnë edhe pjesëmarrjen e tyre në biznese apo angazhime tjera. Përveç kësaj rastet e konfliktit të interesit i identifikojmë edhe nëpërmjet mjeteve të informimit dhe burimeve të tjera.

Shqyrtimi i rasteve të konfliktit të interesit

Rastet e identifikuar si konflikte të mundshme të interesit janë trajtuar duke grumbulluar shënimet dhe informatat e nevojshme. Për të siguruar këto informata, AKK ka pasur bashkëpunim të mirë edhe me institucionet tjera të Republikës së Kosovës, e sidomos këtu do të veçonim Agjensionin Kosovë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK-në) e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Paralajmërimi i personave zyrtar për gjendjen konflikt interesi

Kur AKK ka vërtetuar faktet për ekzistimin e konfliktit të interesit, ka paralajmëruar (njoftuar) me shkrim personat zyrtar se hetohen për gjendjen e konfliktit të interesit. Zyrtarëve në fjalë u është dhënë mundësia që të sjellin argumentet e veta për të dëshmuar të kundërtën. Përndryshe në rastet kur janë pajtuar me paralajmërimin e AKK-së, atëherë kanë bashkëpunuar dhe janë njoftuar për procedurën e shmangies së konfliktit të interesit.

Karakteristikat e paraqitjes

'Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, përcakton se konflikt interesi është gjendja e mospajtitimit ndërmjet detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari'.

Kjo ka qenë bazë me të cilën kemi vepruar. Zakonisht gjatë vitit 2009 situatat më të shpeshta të paraqitjes së konfliktit të interesit janë shfaqur atëherë kur personat e lartë zyrtar përveç se kanë ushtruar një pozitë zyrtare, ata në anën tjetër kanë ushtruar edhe funksione menaxhuese nëpër ndërmarrje të ndryshme private.

Konflikti i interesit i konstatuar, por akoma i pa shmangur

Në mesin e rasteve të vitit 2009, AKK e ka paralajmëruar një zyrtar të lartë në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) për ekzistimin e konfliktit të interesit. Edhe pse kanë kaluar të gjitha afatet ligjore, AKK ende nuk ka marr përgjigje për shmangien e konfliktit të interesit e as për ndërmarrjen e masës që AKK sipas ligjit, i ka propozuar institucionit ku zyrtari i lartë punon që i njëjti të largohet nga puna. Këtu bëhet fjalë për Drejtorin e Zyrës së Prokurimit në ZKM z. Isa Hajdari.

Rastet e konfliktit të interesit të paraqitura në shifra

Për vitin 2009 AKK-ja, ka evidentuar gjithsej 47 raste të konfliktit të mundshëm të interesit. Në 15 raste janë bërë shkresa paralajmëruese për ekzistimin e konfliktit të interesit dhe është kërkuar nga zyrtarët ballafaqimi i fakteve prej të cilave 6 raste është bërë e shmangia e konfliktit të interesit dhe 9 janë në procedurë. 27 raste, pas fazës së dyshimit për konflikt interesi dhe shqyrtimit të më vonshëm nga AKK, kanë rezultuar se nuk kanë elementë të konfliktit të interesit dhe janë mbyllur.

Gjithashtu, gjatë vitit 2009 është vërejtur një bashkëpunim më i madh me institucionet e Kosovës. AKK-ja në 5 raste ka marrë shkresa zyrtare ku është kërkuar opinionin e AKK-së për vlerësimin e situatës së mundshme të konfliktit të interesit. Sidomos kjo ka pasur të bëjë me raste të punësimit nëpër institucione dhe kalimit prej një pozite në tjetrën. Në këto raste ne kemi dhënë opinionin tonë që ka përmbajtur vlerësimin e bazuar në ligj, nëse situatat e tilla paraqesin ose jo konflikt të interesit.

Numri i gjithmbarshëm i rasteve të shqyrtuara të konfliktit të interesit në institucionet e ndryshme për vitin 2009, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nr	Institucioni	Rastet e dyshuara për konflikt interesi	Rastet që janë shmangur konfliktit të interesit	Raste kur kemi dhënë opinion	Raste të mbyllura pa konflikt interesi	Rastet në procedurë
1	Kuvendi i Kosovës	17	3	/	9	5
2	Qeveria e Kosovës	25	3	/	18	4
3	Institucione tjera	5	/	5	/	/
	Totali:	47	6	5	27	9

Tabela 18. Paraqitja tabelare e rasteve të konfliktit të interesit - 2009

Krahasuar me vitin e kaluar, rastet e dyshuara janë më të mëdha për 2 raste, por rastet e konstatuara të konfliktit të interesit janë më të vogla, për 13 raste.

AKK-ja ka konstatuar se kjo ka qenë si rezultat i shtrirjes më të gjerë të njohurive mbi Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike. Por krahas kësaj edhe puna e AKK-se në sensibilizimin e opinionit (zyrtarëve të lartë) për rolin dhe

qëllimin e parandalimit të konfliktit të interesit që e ka bërë gjatë vitit nëpër takime, të ndryshme debate, prezantime, etj.

Aktivitetet e tjera në parandalimin e korrupsionit

- AKK ka vazhduar edhe këtë vit aktivitetin e vet në fushën e parandalimit të keqpërdorimeve të parasë publike në sferën e prokurimit publik. Në këtë aspekt janë ndërmarrë veprime që kanë të bëjnë më fushën e parandalimit të keqpërdorimeve dhe mos zbatimit të rregullave të procedurave të tenderimit. AKK sa herë që ka ardhë në dijeni se në institucione të Republikës së Kosovës dhe në ndërmarrjet publike ka pasur tendenca të shkeljes së Ligjit të Prokurimit Publik, ka intervenuar me qëllim të parandalimit të favorizimeve apo diskriminimit të operatorëve ekonomik nga autoriteti kontraktues.
- AKK me ftesë zyrtare ka bërë vëzhgimin e procedurave të prokurimit që kanë vazhduar në vitin 2009 në Korporatën Energjetike të Kosovës dhe në Ministrinë e Shëndetësisë. Vetë prezenca e zyrtarëve të AKK-së ka bërë që të mos lejohen shkeljet e dispozitave ligjore, mos të ketë favorizime të operatorëve ekonomik. Gjithashtu, AKK i ka dhënë rekomandime autoritetit kontraktues të bazuara në ligj, të cilat më vonë u kanë shërbyer si bazë për veprim në rastet konkrete.
- AKK, ka reaguar edhe në një rast të mos respektimit të kontratës mes operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktues (rasti në Komunën e Podujevës).
- AKK ka reaguar edhe në disa raste të tjera.

VII. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Aktivitetet e AKK-së që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me publikun i ushtron Zyrtaari për Marrëdhënie me Publikun dhe Median në kuadër të Zyrës së Drejtorit. Sa i përket aktiviteteve të saj gjatë periudhës raportuese, Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Median, është përqendruar në këto drejtime:

1. Takimet me gazetarë dhe qytetarë;
2. Konferencat dhe komunikatat për shtyp;
3. Monitorimi i mediave;
4. Faqja zyrtare e internetit;
5. Fushatat sensibilizuese;
6. Bashkëpunimi dhe aktivitetet e tjera.

I. Takimet me gazetarë dhe qytetarë

Gjatë periudhës raportuese, për iniciativat dhe aktivitetet e AKK-së, ka pasur një interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve ashtu edhe nga ana e publikut, ku është demonstruar një gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar ngushtësisht në luftën kundër korrupsionit, si fenomen shqetësues prezent në shoqërinë kosovare.

Përfaqësues të mediave, të shoqërisë civile, sikurse edhe qytetarët e tjerë gjatë gjithë vitit 2009 kanë vizituar zyrat e AKK-së për të marrë informacione e të dhëna të detajuara në lidhje me trendet e korrupsionit apo edhe formën e nxitjes dhe kultivimit të bashkëpunimit.

Zyrtarët e AKK-së kanë qenë gjithmonë të gatshëm që çdo të interesuari ti ofrohet ndihma profesionale si edhe bashkëpunimi në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

II. Konferencat dhe komunikatat për shtyp

AKK gjatë periudhës raportuese, ka luajtur një rol të rëndësishëm në bërjen publike dhe në shpërndarjen e komunikatave për shtyp lidhur me rezultatet e deklarimit të pasurisë së zyrtareve të lartë, në të gjitha mediat e shkruara dhe elektronike.

Gjatë kësaj periudhe janë shpërndarë 22 komunikata për shtyp të cilat janë përcjellur me vëmendje të shtuar në publik. Po ashtu shumë njoftime janë plasuar në publik dhe në këtë drejtim AKK ka organizuar dhe koordinuar disa tryeza të rumbullakëta nëpër komunat e Kosovës për të realizuar njërin nga objektivat e AKK-së vetëdijesimin e publikut kundër korrupsionit.

Këto tryeza që janë mbajtur në shumicën e komunave të Kosovës, si objektivi parësor kanë pasur vetëdijesimin e zyrtarëve komunal, prokurorëve dhe gjyqtarëve, policisë, përfaqësues të ndërmarrjeve publike, mediat lokale dhe shoqërinë civile.

Brenda vitit 2009, zyrtarët e AKK-së kanë marrë pjesë në mbi 70 debate në mediat elektronike (TV dhe Radio). Në shumicën e këtyre aktiviteteve zyra për marrëdhënie me median dhe publikun ka ofruar mbështetjen e duhur për një paraqitje sa më profesionale, si dhe ka qenë e gatshme për t'iu përgjigjur kërkesave të ndryshme që vijnë nga gazetarët mbi iniciativat ose aktivitetet e Agjencisë.

III. Monitorimi i mediave

Janar 2009

- Gjatë këtij muaji janë bërë 16 publikime për afëra korruptive ku gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike;
- Raportet e auditimit kanë qenë pikat ku gazetarët kanë qenë të fokusuar më së shumti. Po ashtu afëra korruptive në KEK ku flitet për pagat astronomike, kontrabanda me mallra në Doganat e Kosovës dhe arrestimi i personave zyrtarë në këtë institucion.

Shkurt 2009

- Në këtë muaj janë bërë 23 publikime për raste të dyshuara korruptive nëpër institucionet publike, ku në veçanti kritikohen prokuroritë dhe gjykatat e Kosovës.

Po ashtu shoqëria civile dhe mediat kanë kritikuar menaxhmentin e PTK-së për keqpërdorime. Mediat nuk kane lënë anash as Projektin e zhvendosjes së fshatit Hade.

- Shkrimet tjera kanë të bëjnë me afëra korruptive nëpër spitale dhe KEK etj.

Mars 2009

- Gjatë këtij muaji janë publikuar 24 shkrime të cilat i janë referuar ekskluzivisht aktiviteteve të AKK-së ku është trajtuar çështja e deklaramit të pasurisë.
- Në muajin mars është shkruar shumë për blerjen e 6 veturave në vitet 2004 për Zyrën e Presidentit dhe Kuvendin e Kosovës.
- Po ashtu, është shkruar shumë për keqpërdorimet në fushën e gjyqësisë ku janë ngritur kallëzime penale ndaj një gjyqtari dhe një prokurori.

Prill 2009

- Gjatë këtij muaji janë publikuar 25 shkrime për aktivitetet e AKK-së.
- Pas komunikatës së AKK-së për deklarimin e pasurisë, shkrimet kanë qenë të fokusuar rreth mos deklaramit të pasurisë së disa zyrtarëve. Po ashtu shkarkimi i disa zyrtarëve nga ana e Qeverisë, pas daljes së Raportit të AKK-së, ka bërë bujë të madhe në opinion.
- Shkrimet e tjera kanë qenë kryesisht të fokusuar në keqpërdorimin e detyrës si vjedhja në polici, konflikti i interesit të një deputeti në Kuvendin e Kosovës etj.

Maj 2009

- Gjithsej 21 artikuj në gazeta.
- Të gjitha mediat kanë raportuar përkitazi me arrestimin e një mjeku në Fushë Kosovë për vjedhjen e aparaturës pas hetimeve të AKK-së, suspendimin nga puna të dy inspektorëve në Komunën e Prishtinës.
- Shkrimet kanë qenë kryesisht të fokusuar në suspendimin e dy eprorëve të lartë në polici për shkak të dhomës së dëshmive.

Qershor 2009

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 10 shkrime që kanë pasur të bëjnë me hetimet kundër gjykatësve dhe prokurorëve që janë burgosur për ryshfet; rasti gjykatësve dhe prokurorëve të suspenduar muajve të fundit mediat i kanë kushtuar shumë gjykatave, prokurorëve, për mospunën e tyre në raste të ndryshme. - Është trajtuar Raporti i Transparency Internacional i cili e rendit Kosovën për nga niveli i korrupsionit me notën 3,4 (ndërsa nota 5 është korrupsion ekstrem).
- Është shkruar për kthimin e mjekut Agim Xhafa në punë pas skandalit me aparaturën e QKUK-së.

Korrik 2009

- Gjatë këtij muaj janë publikuar 63 shkrime. Gazetarët janë fokusuar në të gjitha institucionet e ndryshme publike. Arrestimi i punonjësve të insitucioneve të drejtësisë, 11 avokatëve, 1 gjyqtari dhe 1 zyrtari të sigurimeve si të dyshuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe mashtrim.
- Raportet e auditimit në MASHT, MAP, MMPH, Kuvendi i Kosovës dhe nëpër komunitat e Kosovës, gjejnë një varg parregullsi edhe pse janë përshëndetur raportet nga udhëheqësit e këtyre insitucioneve si shumë korrekte. Problem tjetër i përfolur në media ka qenë tenderi për produktet e mishit etj.

Gusht 2009

- Janë publikuar 47 shkrime për raste të dyshuara si veprime korruptive nga institucionet publike duke filluar nga prokuroria dhe gjyqësia e Kosovës ku dyshohet për mbylljen e rasteve korruptive.
- Raportet e auditimit për MBPZHR, MPB, Doganave të Kosovës.
- Arrestimi i komandantit të policisë në Obiliq Sejdi Zeqiri për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Po ashtu edhe arrestimi dy zyrtarëve të policisë kufitare për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Mediat kanë bërë publike bonueset e zyrtarëve të lartë të PTK-së dhe shumë gjëra tjera që lidhen me menaxhimin në këtë organizatë.

Shtator 2009

- Gjatë këtij muaji janë evidentuar 7 shkrime të cilat i referohen raporteve të Auditorit të Përgjithshëm për shkeljet në të gjitha insitucionet publike.

Tetor 2009

- Në këtë muaj janë botuar 25 shkrime duke filluar prej keqpërdorimeve në Agjencinë Pyjore të Kosovës, ku raporti i auditimit gjen shkelje të rënda për të cilin rast AKK ka filluar hetimet e këtij rasti. Arrestimi i 12 pjesëtarëve të dyshimtë të policisë se kanë kryer dy vepra penale: marrje të ryshfetit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtare.
- Mediat kanë raportuar edhe për lëshimin e diplomave falso të shkollës së lartë pedagogjike në Gjakovë.

Nëntor 2009

- Gjithsej 17 artikuj në gazeta ku mediat kanë shkruar në këtë muaj kryesisht për auditimet e bëra.
- Shkrimet tjera kanë pasur të bëjnë për ndërmarrjet e tjera publike. Po ashtu mediat kanë bërë publike rastin kur një kompani hungareze, e ka fituar tenderin për certifikata të gjendjes civile, edhe pse me çmim më të shtrenjtë.

Dhjetor 2009

- Gjatë këtij muaji kanë qenë 5 shkrime që kanë të bëjnë me keqpërdorimet në ndërmarrjen publike Termokos, auditimi në MEM ku nxjerr shumë shkelje. Po ashtu

auditimi nëpër komuna ka nxjerr shumë parregullsi për tenderët dhe pronat komunale.

Në figurën e mëposhtme, janë të paraqitura në mënyrë grafike të dhënat në lidhje me 283 shkrimet për aferat korruptive të ndara sipas muajve.




Fig. 7. Numri i shkrimeve të mediave për dyshime në lidhje me veprime korruptive, sipas muajve të vitit 2009

Sa i përket punës së AKK-së janë botuar gjithsej 156 artikuj, intervista, komente, opinione. Mbi 90% të tyre kanë qenë pozitive për punën e AKK-së, të paraqitura në figurën e mëposhtme.




Fig. 8. Shkrimet e mediave për AKK-në, sipas muajve të vitit 2009.

IV. Faqja zyrtare e internetit

AKK gjatë gjithë vitit ka vazhduar të mirëmbajë faqen zyrtare të internetit. Përmes saj janë përcjellur tek publiku i tërë aktiviteti i Agjencisë. Të gjithë të interesuarit të cilët do të përdorin këtë faqe kanë mundësi të marrin informacionin e detajuar për aktivitetin e AKK-së dokumentet ligjore të saj, por edhe paralajmërimet për aktivitetet e radhës.

Faqja zyrtare e AKK-së është kjo www.akk-ks.org.

V. Bashkëpunimi dhe aktivitetet tjera

AKK vazhdimisht ka kultivuar frymën e bashkëpunimit të mirë me shumë institucione dhe organizata si vendore ashtu edhe ndërkombëtare.

Me ftesën e drejtorit të AKK-së z. Hasan Preteni, me 16 qershor për një vizitë dy ditore në Kosovë, qëndroi delegacioni i përbërë prej 7 zyrtarëve të Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive të Republikës së Shqipërisë, i udhëhequr nga Kryeinspektori Adriatik Llalla. Qëllimi i kësaj vizite, ishte thellimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave midis dy institucioneve.

VI. Organizimi i Konferencës Rajonale në Prishtinë

Në përpjekje për ta forcuar rolin e vetë dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal, AKK në bashkëpunim me zyrën e UNDP-së në Kosovë, në dhjetor 2009, organizuan konferencën rajonale "Këmbimi i përvojave anti-korrupsion". Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të shumtë të agjencive anti-korrupsion nga Sllovenia, Mali i Zi, Shqipëria, Kroacia, (IRJ) Maqedonia, Turqia dhe Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI). Konferenca ka qenë e financuar nga Qeveria Japoneze përmes projektit të menaxhuar nga UNDP.

Kjo ngjarje, e organizuar brenda kornizës së projektit të UNDP-së "Partneriteti Kosovar Kundër-Korrupsionit", ofroi një mundësi për të shkëmbyer dhe diskutuar iniciativat dhe misionet e agjencive nga vendet e rajonit në luftën kundër korrupsionit, themelimit të mekanizmave ndërlidhës dhe kultivimin e një qasjeje shumë-disiplinore të bashkëpunimit ndërmjet tyre.

VII. Ndarja e çmimit për gazetari

Ndër aktivitetet e muajit dhjetor ishte edhe ndarja e çmimit në gazetari me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Korrupsionit, e cila u bë më 9 Dhjetor. Asociacioni i Gazetarëve Profesionistë të Kosovës, Agjencia kundër Korrupsionit dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), organizuan ceremoninë e ndarjes së shpërblimeve për gazetarët të cilët kanë raportuar më së miri mbi tematikën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit në Kosovë gjatë vitit 2009.

AKK, ka shprehur gatishmërinë e plotë për thellimin e bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat e tjera vendore dhe ndërkombëtare.

VIII. ADMINISTRATA / BUXHETI

Aktivitetet e mbështetjes administrative në AKK ushtrohen nga Departamenti i Administratës, këto aktivitete konsistojnë në:

1. Hartimin e Buxhetit vjetor;
2. Mbikëqyrjen e realizimit të shpenzimeve;
3. Menaxhimi i burimeve njerëzore;
4. Aktivitetet e tjera mbështetëse.

1. Hartimi i Buxhetit vjetor

AKK ka bërë hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor, duke vlerësuar nevojat financiare për shpenzimet për vitin në vijim. Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Kosovës për AKK-në, për vitin 2009, ka qenë 504,553.48 €, ndërsa i ndarë sipas kategorive ekonomike, në mënyrë tabelare duket kështu:

Nr	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar	Buxheti rishikuar	i Ndryshimi
1.	Pagat dhe mëditjet	212,601.48 €	212,601.48 €	0,00
2.	Mallra dhe Shërbime	226,952.00 €	226,952.00 €	0,00
3.	Shpenzimet Komunale	20,000.00 €	20,000.00 €	0,00
4.	Shpenzimet Kapitale	45,000.00 €	45,000.00 €	0,00
5.	Gjithsej :	504.553.48 €	504.553.48 €	0,00

Tabela 20: Alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike

2. Mbikëqyrja e realizimit të shpenzimeve

Gjatë vitit 2009, nga buxheti i miratur nga Kuvendi i Kosovës, AKK ka realizuar 79.44% të buxhetit të paraparë. Buxheti i ndarë për:

- Kategorinë **Paga dhe Meditje** është realizuar në masën 77.23%. Kjo ka ndodhur për arsye se mjetet e ndara për këtë kategori që kanë të bëjnë shtesën për rrezikshmërinë në punë për të gjithë zyrtarët e AKK-së, nuk i janë lejuar nga MEF-i edhe pse për të njëjtën çështje, AKK-ja ju ka drejtuar këtij institucioni me disa shkresa zyrtare;

- **Kategoria Mallra dhe Shërbime** është realizuar 81.08% nga buxheti i planifikuar për këtë kategori. Në tabelën e mëposhtme;
- Kategoria **Shpenzimet e komunalive** është realizuar në masën 45.22 % të buxhetit të planifikuar;
- Kategoria **shpenzimet kapitale** është realizuar në masën 96.39 % të buxhetit të planifikuar.

Këto të dhëna në mënyrë tabelare duken si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Buxheti aprovuar	Alokimi	Shpenzimet	Shpenzimet shprehur ne %
1	Pagat dhe mëditjet	212,601.48	212,601.48	164,380.66	77.23
2	Mallra dhe shërbime	226,952.00	226,952.00	184,017.50	81.08
3	Shpenzimet e komunalive	20,000.00	20,000.00	9,044.77	45.22
4	Shpenzimet kapitale	45,000.00	45,000.00	43,377.38	96.39
	Gjithsejtë	504,553.00	504,553.00	400,820.31	79.44

Tabela 21: Realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2009 AKK i ka shpenzuar vetëm 1993.85 € të parave të imëta (petty cash).

3. Menaxhimi i burimeve njerëzore

AKK, gjatë periudhës raportuese ka bërë shpalljen e konkurseve për pozitat e më poshtme:

- o Drejtor i Departamentit të Administratës;
- o Shef i Divizioni për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave ;
- o Zyrtarë të Lartë për Mbikëqyrjen e Pasurisë dhe Dhuratave;
- o Zyrtarë të Lartë për Zbulim dhe Hetime;
- o Zyrtarë i Lartë për IT;
- o Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa;
- o Zyrtar Administrativ.

Të gjitha pozitat janë shpallur në gazetën ditore në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërsa në radio vetëm në gjuhën serbe. Vendimet për komisionet e selektimit dhe intervistimit janë bërë ashtu si është paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36, pastaj komisioni me një përgjegjësi të plotë ka vazhduar punën e tyre. Nga të gjitha këto pozita kemi të punësuar gjashtë zyrtarë, të gjithë të punësuarit janë pajisur me kontrata pune tre vjeçare, me periudhë provuese tre mujore. Kontratat dhe vendimet janë përcjellur dhe janë futur në sistem të pagave nga MAP-j.

Është bërë edhe vlerësimi i periudhës një vjeçare të punës për të gjithë zyrtarët e Agjencisë, çka ka bërë që të njëjtit të jenë pjesë e stafit tonë.

Për këtë periudhë kohore janë bërë edhe një numër kërkesash nga Divizioni i Personelit për MAP-në që shumica kishin për qëllim miratimin e titujve të ri të punës në kuadër të AKK-së.

Gjatë kësaj kohe kemi pasur edhe një numër trajnimesh dhe vizita studimore si në vend ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim avancimin dhe efikasitetin në punë për zyrtarët e Agjencisë.

Nr	Lloji i Trajnimit	Organizimi nga	Vendi	Numri i zyrtarëve pjesëmarrës
1	Efikasiteti në administratë, etika dhe protokoli i zyrës.	IKAP	Prishtinë	2
2	Teknikat e Hartimit të Ligjeve	IKAP	Prishtinë	2
3	Efikasiteti në administratë, etika dhe protokoli i zyrës.	IKAP	Prishtinë	1
4	Hyrje ne Parandalimin e Krimet Financiar	MPB-PK	Vushtrri	1
5	Qeverisje Elektronike	IKAP	Prishtinë	1
6	Efikasiteti në administratë, etika dhe protokoli i zyrës.	IKAP	Prishtinë	1
7	Hyrje ne Parandalimin e Krimet Financiar	MPB-PK	Vushtrri	1
8	Hyrje ne Parandalimin e Krimet Financiar	MPB-PK	Vushtrri	1
9	Zhvillimi dhe implementimi i politikave publike	IKAP	Prishtinë	1
10	Kursi themelor mbi hetimet e krimet financiar	MPB-PK	Vushtrri	1
11	Menaxhimi dhe organizimi i zyrës	IKAP	Prishtinë	1
12	Teknologji Informative	IKAP	Prishtinë	1
13	Hetimi i Falsifikimit	MPB-PK	Vushtrri	1
14	Hetimi i Falsifikimit	MPB-PK	Vushtrri	1
15	Menaxhimi dhe organizimi i zyrës	IKAP	Prishtinë	1
16	Etika dhe Anti-korrupsioni	IKAP	Prishtinë	1
17	Moduli i Blerjeve	MEF	Prishtinë	1
18	Menaxhimi i IT-së dhe komunikimi nëpër Ministri	IKAP	Prishtinë	1
19	Planifikim Strategjik	IKAP	Prishtinë	1
20	Hetimi i kontrabandës dhe shkeljet e të hyrave doganore	MPB - PK	Vushtrri	2
21	Mirëmbajtja e ueb faqes	IKAP	Prishtinë	1
22	Moduli i aprovimeve	RK/ MEF	Prishtinë	1
23	Moduli i të Hyrave	RK/ MEF	Prishtinë	1
24	Aspekti ligjor i luftës kundër korrupsionit	USAID	Prishtinë	6
25	Prokurimi elektronik dhe praktikat me te mirat te PP	FLSA	Durrës	2

26	Moduli i Aprovimeve	MEF	Prishtinë	1
27	Moduli i Blerjeve	MEF	Prishtinë	1
28	Marrëdhëniet juridike të punës për nënpunsit civil	IKAP	Prishtinë	1
29	Menaxhimi i Buxhetit	LDC	Ohër	3

Tabela 23. Lista e trajnimeve të ndjekura nga zyrtarët e AKK-së gjatë vitit 2009.

4. Aktivitetet tjera

AKK ka bërë krijimin e një baze të dhënash për regjistrimin dhe arkivimin e të gjitha veprimeve financiare. Është bërë sigurimi i objektit në koordinim me kompanitë apo agjencitë që kanë përsipër sigurimin e objektit, megjithëse objekti nuk ofron kushte të mira dhe hapësirë të mjaftueshme për punë. Janë menaxhuar shërbimet postare duke siguruar shpërndarjen e shkresave në kohë dhe destinacionin e caktuar. Po ashtu ka bërë menaxhimin e mallrave dhe furnizimin me materialet e nevojshme.

IX. PROKURIMI

Për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit në bazë të planifikimit duke u bazuar në Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës, gjatë vitit 2009 AKK ka shpenzuar shumën prej 156,680.83€.

Aktivitetet e zyrës së Prokurimit për periudhën raportues kanë qenë:

- Planifikimi preliminar dhe planifikimi përfundimtar pas aprovimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës për vitin fiskal 2009,
- Inicimi i aktiviteteve të prokurimit,
- Njoftimi për kontratë,
- Publikimi i njoftimeve ,
- Përgatitja e dosjeve,
- Dorëzimi i dosjeve të tenderit,
- Pranimi i tenderëve, hapja e tyre, vazhdimi i procedurës së kontrollimit, vlerësimit, dhe krahasimit të tenderëve, dhënia dhe nënshkrimi i kontratave duke kërkuar realizimin në pajtueshmëri të plotë me afatet dhe kushtet e kontratës.

Gjatë vitit 2009 janë përgatitur dhe zhvilluar 39 aktivitete të prokurimit të cilat shihen në tabelën e mëposhtme:

Nr	Lloji i prokurimeve	Nr.i aktiviteteve	Kodi i procedurës	Shuma
1	Furnizim	6	Procedurë e vlerës minimale	3,638.30€
2	Shërbime	12	Procedurë e vlerës minimale	4,379.44€
3	Furnizim	7	Procedurë e kuotimit të çmimeve	19,853.05€
4	Shërbime	3	Procedurë e kuotimit të çmimeve	11,757.88€
5	Furnizim	1	Procedurë e hapur	60,994.73€
6	Shërbime	1	Procedurë e hapur	1,636.97€

7	Furnizim	3	Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	45,980.00€
8	Shërbime	6	Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	8,440.46€
TOTALI		39		156,680.83€

Tabela 24. Aktivitetet e prokurimit të AKK-së sipas procedurës

Aktivitetet e AKK-së sipas procedurave të prokurimit janë zhvilluar si në vijim:

- 18 aktivitete të prokurimit furnizim dhe shërbime me procedurë të vlerës minimale;
- 10 aktivitete të prokurimit furnizim dhe shërbime me procedurë të kuotimit të çmimeve;
- 2 aktivitete të prokurimit furnizim dhe shërbime me procedurë të hapur;
- 9 aktivitete me procedurë të negociuar pa publikim e njoftimit të kontratës për furnizime dhe shërbime të aprovuara nga APP;
- 1 aktivitet i prokurimit është anuluar nga autoriteti kontraktues pasi janë pranuar më pak se 3 tenderë të përgjegjshëm apo kërkesa për pjesëmarrje;
- 1 aktivitet i prokurimit janë refuzuar nga APP;
- Furnizimi me derivate të naftës gjatë periudhës raportuese ka vazhduar nga aktiviteti i prokurimit i zhvilluar në vitin 2008.

Të shprehura në formë tabelare, rezultatet duken kështu:

NR	LLOI I PROKURIMEVE	NR.I AKTIVITETEVE	KODI I PROCEDURËS	MJETET E PLANIFIKUARA	MJETET E SHPENZUARA	%
1	Furnizim	6	Procedurë e vlerës minimale	4,290.00€	3,638.30€	84.81
2	Shërbime	12	Procedurë e vlerës minimale	6,080.00€	4,379.44€	72.03
3	Furnizim	7	Procedurë e kuotimit të çmimeve	28,000.00€	19,853.05€	70.90
4	Shërbime	3	Procedurë e kuotimit të çmimeve	15,100.00€	11,757.88€	77.87
5	Furnizim	1	Procedurë e hapur	78,180.00€	60,994.73€	78.02
6	Shërbime	1	Procedurë e hapur	4,000.00€	1,636.97€	40.92
7	Furnizim	3	Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	46,200.00€	45,980.00€	99.52
8	Shërbime	6	Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë	14,100.00€	8,440.46€	60.00
Totali				195,950.00€	156,680.83€	79.96%

Tabela 25. Lista e aktiviteteve të prokurimit sipas përqindjes së realizuar.

Departamenti për Mbikëqyrje dhe Monitorim pranë Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës, ka bërë monitorimin dhe mbikëqyrjen e disa aktiviteteve të prokurimit të realizuara në vitin 2008 në zyrën e prokurimit të AKK-së ku vlerësimi i të cilit ka qenë pozitiv.

X. SFIDAT DHE VËSHIRËSITË

Sfidat dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar AKK gjatë punës mund të përmenden:

- Mungesa bashkëpunimit dhe koordinimit të mirë ndërinstitucional;
- Mungesa e trajnimeve të thelluara për teknikat bashkëkohore të hetimit dhe parandalimit të korrupsionit;
- Bashkëpunimi jo i kënaqshëm me institucionet tjera simotra në shtetet e rajonit në lidhje me aspektet e mënyrave të zbulimit dhe hetimet të rasteve të korrupsionit;
- Trajtimi jo adekuat financiar për zyrtarët e AKK-së.
- Problem shqetësues ka qenë edhe largimi i disa zyrtarëve nga Agjencia dhe kalimi i tyre nëpër institucione të tjera, për shkak të pagave të ulëta.
- Mungesa e hapësirës adekuate (objektit) për ushtrimin e veprimtarisë së AKK-së.

XI. PËRFUNDIM

Gjatë përmbushjes së mandatit ligjor, AKK është ballafaquar me vështirësi të shumta të cilat e kanë vështirësuar funksionalitetin e tërësishëm të tij.

Vlen të përmendet se mospërkrahja adekuate, kushtet e vështira të funksionimit, stimulimi jo i duhur financiar i zyrtarëve dhe mungesa e trajnimeve të specializuara të cilat e kanë sfiduar realizimin e plotë të synimeve të AKK-së.

Përkundër kësaj, AKK në saje të angazhimit dhe përkushtimit të plotë ka arritur të mënyrë të konsiderueshme të përballet me fenomenin e korrupsionit, duke rritur numrin e rasteve të hetuara, rasteve të proceduara në prokuroritë kompetente si dhe rasteve të parandaluara. Shtimi i rasteve të raportuara të korrupsionit, gjithashtu dëshmon rritjen e besimit të qytetarëve për punën e AKK-së.

Me kompletimin dhe fuqizimin e zbatimit të kuadrit ligjor si dhe me zbatimin e plotë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit 2009 - 2011, me përkrahjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, me reformën e përgjithshme të sistemit të drejtësisë, lufta kundër korrupsionit në vitin 2010 do të jetë edhe më e fuqishme.

XII. SHTOJCA I: ORGANOGRAMI

